

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. nr. 184/15

8 gusht 2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Katrien Gabriël Witteman si Kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët e EULEX-it Iva Niksic dhe René van Veen si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Chiara Tagliani si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër:

Xh. K., momentalisht në paraburgim që nga data 7 tetor 2015;

I akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të datës 9 nëntor 2015 me numrin PPS 08/09 për kryerjen e veprave penale:

“Krime lufte kundër popullatës civile” nën disa pika të aktakuzës, siç parashihet dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)¹, në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977;

dhe

“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” siç parashihet dhe e dënueshme me nenin 374, paragrafi 1 i ndërlidhur me nenin 120, pika 38 e KPRK-së;

¹ Ligji nr. 04/L-082

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të gjitha të hapura për publikun, me 18 mars 2016, 11, 12, 13, 18, 19, 20 dhe 25 prill 2016, 13, 23, 24, 25 dhe 30 maj 2016, 7, 8, 12, 14 korrik 2016 dhe 2 e 4 gusht 2016 në prani të prokurores speciale të Republikës së Kosovës znjsh. Damare Theriot (në të gjitha datat e lartpërmendura përveç me 2 dhe 4 gusht 2016) dhe z. Charles Hardaway (vetëm me 2 dhe 4 gusht 2016), i akuzuari **Xh. K.** dhe avokatët e tij mbrojtës Haxhi Millaku dhe Meriman Vehapi;

Pas këshillimit dhe votimit në përputhje me nenet 357 të KPP-së me 5 gusht 2016;

Në përputhje me nenet 362, 363, 364, 365, 366, 450, 451 dhe 453 të KPP-së;

Lëshon të mëposhtmin:

AKTGJYKIM

I

AKUZA I

Krime lufte kundër popullatës civile, siç parashihet dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) , në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977 e cila ishte në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë kërkesë, e kryer në qendrat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në K. dhe C. (Shqipëri):

Nën pikën 1: Vrasje si Krim lufte kundër popullatës civile

I pandehuri **XH. K.** është shpallur i **PAFAJSHËM,**

Për shkak se **NUK** është vërtetuar se:

I pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së që mbante një post të lartë rangues në qendrën e UÇK-së në K. (Shqipëri), në bashkëkryerje me anëtarët e tjerë të UÇK-së, ka vrarë A. B. gjersa ai ka qenë i burgosur në mënyrë të paligjshme në kampin e K. duke e rrahur dhe duke shtënë në të,

Në K. (veri të Shqipërisë) me 4 apo 5 qershor 1999.

Prandaj, në pajtim me nenin 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 i KPP-së i akuzuari **XH. K.** lirohet nga ajo pikë.

Nën pikën 2: Mbajtje të paligjshme si Krim lufte kundër popullatës civile

I pandehuri XH. K. është shpallur FAJTOR

Për shkak se është vërtetuar se:

I pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së në bashkëkryerje me S. G. dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së, ka arrestuar dhe mbajtur në mënyrë të paligjshme dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H, K, A. B. dhe civilë të tjetër të panjohur në një qendër të tillë për një periudhë të gjatë kohore,

Në K. (veri të Shqipërisë) gjatë muajit prill, maj dhe mesit të muajit qershor të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **XH. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për aktin e Krimin të luftës kundër popullatës civile, siç parashihet dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977 e cila ishte në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë kërkesë.

Nën pikën 3: Kushte çnjerëzore si Krim lufte kundër popullatës civile

I pandehuri **XH. K.** shpallet **FAJTOR**,

Për shkak se është vërtetuar se

I pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së në bashkëkryerje me S. G. dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së, ka mbajtur dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H, K, A. B. dhe civilë të tjetër të panjohur në ndalim në një qendër të tillë në kushte çnjerëzore (qeli të vogla me mungesë të ujit, ushqimit, sanitarisë , ajrit dhe qasjes në trajtimin mjekësor)

Në K. (veri të Shqipërisë) gjatë muajit prill, maj dhe mesit të muajit qershor të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **XH. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për aktin e luftës kundër popullatës civile, siç parashihet dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) , në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977 e cila ishte në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë kërkesë.

Nën pikën 4: Torturë si Krim lufte kundër popullatës civile ,

I pandehuri **XH. K.** shpallet **FAJTOR**,

Për shkak se është vërtetuar se

I pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së në bashkëkryerje me S. G. dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së,

-ka torturuar dëshmitarët A, B, C, H dhe A. B. duke i rrahur ata deri në pavetëdije me shkopinjë gome dhe shkopinjë druri,

Në K. (veri të Shqipërisë) në një datë të panjohur të muajit maj të vitit 1999.

Duke vepruar kështu, i pandehuri **XH. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për aktin e krimit të luftës kundër popullatës civile, siç parashihet dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) , në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977 e cila ishte në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë kërkesë.

Nën pikën 5: Shkelje e Integritetit trupor apo shëndetit si Krim lufte kundër popullatës civile

I pandehuri **XH. K.** shpallet **FAJTOR**,

Për shkak se është vërtetuar se

I pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së në bashkëkryerje me S. G. dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së, ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e dëshmitarëve A, B, C, D, E, F, H, dhe A. B. duke i rrahur ata në mënyrë të vazhdueshme apo duke i urdhëruar të tjerët të veprojnë në atë mënyrë,

Në K. (veri të Shqipërisë) gjatë muajit prill, maj dhe mesit të muajit qershor të vitit 1999.

Duke vepruar kështu i pandehuri **XH. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për aktin e Krimit të luftës kundër popullatës civile, siç parashihet dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të KP i RSFJ-së, e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 31 dhe 152 të KPRK-së, në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977 e cila ishte në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë kërkesë.

Nën pikën 6: Mbajtje të paligjshme si Krim lufte kundër popullatës civile

I pandehuri **XH. K.** shpallet **FAJTOR**,

Për shkak se është vërtetuar se

I pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së në bashkëkryerje me anëtarët e tjerë të UÇK-së

- ka mbajtur në mënyrë të paligjshme dëshmitarët K, L, M dhe N në kampin e UÇK-së në C. (veri të Shqipërisë) gjatë muajit prill, maj dhe mesit të muajit qershor të vitit 1999, dhe

- ka mbajtur në mënyrë të paligjshme dëshmitarët L dhe N në një garazh në Pr. në data të papërcaktuara gjatë muajit qershor të vitit 1999.

Duke vepruar kështu i pandehuri **XH. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për aktin e Krimin të luftës kundër popullatës civile, siç parashihet dhe e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të KP i RSFJ-së, e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 8, 31 dhe 152 të KPRK-së , në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977 e cila ishte në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë kërkesë.

Pika 7: Shkelje e Integritetit trupor apo shëndetit si Krim lufte kundër popullatës civile

e dënueshme me nenet 22 dhe 142 të KP i RSFJ-së, e cila momentalisht është e ndëshkueshme sipas nenit 31 dhe 152 të KPRK-së , në shkelje të nenit 3 të përbashkët të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit shtesë II të vitit 1977 e cila ishte në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për këtë kërkesë.

I pandehuri në bashkëkryerje me anëtarët e tjerë të UÇK-së në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të panjohur nga Pre.

Në C. (veri të Shqipërisë) në një datë të panjohur në muajin maj apo qershor të vitit 1999

Është refuzuar në përputhje me nenin 363 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të KPP-së

Për shkak se prokurori i PSRK-së ka tërhequr pikën e aktakuzës gjatë shqyrtimit gjyqësor .

Nën AKUZËN PENALE 2: Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’’.

I pandehuri **XH. K.** shpallet **FAJTOR**,

Për shkak se është vërtetuar se

në datën e arrestimit të tij (06.10.2015) një armë 7.62 mm M56 dhe tri thika mbërthyese ishin gjetur në veturën e tij,

në Pr. (Kosovë) me 6 tetor 2015

Duke vepruar kështu, **XH. K.** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të **Mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**’’ siç parashihet dhe e dënueshme me nenin 374, paragrafi 1 i ndërlidhur me nenin 120, pika 38 të KPRK-së

II.

I pandehuri XH. K. DËNOHET

Për AKUZËN PENALE 1

Për pikën 2

Me **5 (vjet) vjet** burgim;

Për pikën 3

Me **6 (gjashtë) vjet** burgim;

Për pikën 4

Me 7 (shtatë) vjet burgim;

Për pikën 5

Me 6 (gjashtë) vjet burgim;

Për pikën 6

Me 6 (gjashtë) vjet burgim;

Për akuzën penale 2

Me gjobë prej 1.500€(një mijë e pesëqind euro).

Në përputhje me nenin 80 të KPRK-së

I pandehuri XH. K. DËNOHET

Me dënim unik prej 8 (tetë) viteve burgim dhe një gjobë prej 1.500€ (një mijë e pesëqind euro).

Në përputhje me nenin 83 paragrafi 1 i KPRK-së

Koha e kaluar në paraburgim si dhe çfarëdo periudhe tjetër e privimit nga liria lidhur me veprat penale që nga 6 tetori 2015 deri sot janë të përfshira në burgim.

III.

Sendet e konfiskuara

Sendet në vijim, të konfiskuara përkohësisht me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 12 tetor 2015:

1. Pistoleta M57 kal.7.62 nr. serik 19Z45Z

2. 2 karikatorë të mbushur- gjithsej 19 plumba
3. 1 këllëf të pistoletës
4. 1 thikë të mprehtë të zezë që mbyllet
5. 1 thikë të mprehtë të gjelbër që mbyllet
6. 1 thikë të kuqe me shumë funksione

do të shkatërrohen në përputhje me nenin 115 paragrafin 5 të KPP-së.

IV.

Palët e dëmtuara

Trupi gjykues thekson se palët e dëmtuara nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë për kompensim gjatë gjykimit. Ata udhëzohen se mund të realizojnë kërkesat e tyre pronësore-juridike në kontest civil.

V.

Shpenzimet e procedurës

Në përputhje me nenin 453 paragrafin 1 të KPP-së, i pandehuri do të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumën e caktuar prej 2.000€(dy mijë euro).

ARSYETIM

I HISTORIATI PROCEDURAL

1. Më 13 korrik 2009 ishte iniciuar një hetim kundër S. G. për shumë akuza për krime lufte kundër popullatës civile gjoja të kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Më 23 dhjetor 2009, hetimi u zgjerua për të përfshirë të pandehurin **Xh. K.** për të njëjtën vepër penale. Më 16 qershor 2010, hetimi u zgjerua për të përfshirë R. A.. Me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 28 qershor 2010 ishin vazhduar hetimet kundër të pandehurit **Xh. K.** deri më 24 dhjetor 2010.

2. Më 6 gusht 2010 prokurori ngriti aktakuzën PPS 08/09 kundër S. G. dhe R. A.. I pandehuri **Xh. K.** nuk ishte përfshirë në aktakuzë, pasi ai ishte në arrati. Procedurat u bashkuan me procedurën kundër H. H., S. R. dhe Sh. H. të cilët ishin duke u ndjekur penalisht për të njëjtat vepra penale. Rasti i S. R. më vonë u nda për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.
3. Më 8 tetor 2010 ishte lëshuar një urdhër arresti kundër të pandehurit **Xh. K.**
4. Me aktgjykimin e datës 29 korrik 2011 të Gjykatës (së atëhershme) së Qarkut në Mitrovicë, S. G., R. A., H. H. dhe Sh. H. u dënuan me 15, 12, 6 dhe 7 vjet burg². S. R. ishte dënuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës të datës 13 tetor 2011 dhe u dënuar me pesë vjet burgim³. Aktgjykimet ishin ndryshuar pjesërisht dhe ishin konfirmuar për pjesën e mbetur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013⁴. Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura nga S. R. dhe R. A. janë refuzuar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të datës 7 maj 2014, ndërsa në të njëjtën aktgjykim kërkesa e S. G. ishte miratuar vetëm në lidhje me pikat të cilat nuk ishin relevante për akuzën e krimeve të luftës⁵.
5. Më 6 tetor 2015 i pandehuri **Xh. K.** u arrestua në Pr.. Më 7 tetor 2015, gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi paraburgimin e tij i cili që nga atëherë është vazhduar për të skaduar në ditën kur ky aktgjykim merr formën e prerë.
6. Më 9 nëntor 2015, prokurori paraqiti aktakuzën me numër PPS 08/09 kundër të pandehurit **Xh. K.** Më 18 nëntor 2015 ishte mbajtur një seancë fillestare në bazë të nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP)⁶. Gjatë seancës, i pandehuri u deklarua i pafajshëm për akuzën e krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe fajtor për akuzën e mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve.
7. Më 16 dhjetor 2015, avokati mbrojtës Haxhi Millaku paraqiti një kërkesë me shkrim për hudhjen e aktakuzës në të cilën prokurori u përgjigj më 28 dhjetor 2015. Në një aktvendim të

² Gjykata e Qarkut të Mitrovicës *S.G. e të tj.* (P 45/2010), Aktgjykimi, 29 korrik 2011

³ Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, *S.R.*(P 45/2010), Aktgjykimi, 13 tetor 2011

⁴ Gjykata e Apelit, *S.G. e të tj.* (PAKR 966/2012), Aktgjykimi, 11 shtator 2013

⁵ Gjykata Supreme, *S.G. e të tj.*(Pml.Kzz.1/2014), Aktgjykimi, 7 maj 2014, f. 3 prej 15

⁶ Ligji nr. 04/L-123

datës 27 janar 2016, kryetari (i atëhershëm) i trupit gjykues e refuzoi kërkesën e avokatit mbrojtës dhe i ka shpallur të pranueshme të gjitha provat e propozuara nga prokurori.

II LIGJI I APLIKUESHËM

8. Në akuzën 1 të aktakuzës, i pandehuri është i akuzuar me shtatë pika për "Krime lufte kundër popullatës civile", që parashihen dhe dënohen me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP i RSFJ-së), aktualisht e dënueshme sipas neneve 31 dhe 152 të KPRK-së, në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe nenet 4 dhe 5 të Protokollit të tyre shtesë II të vitit 1977, të kryer në qendrat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të cilat gjenden në K. dhe C. (Shqipëri) gjatë muajit prill, maj dhe qershor 1999.

II.1 Ligji i aplikueshëm material

9. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, neni 1, paragrafi 1.1 nën (b), e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59, ligji që ka qenë në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, KP i RSFJ-së, është ligji i aplikueshëm material në këtë rast. Kjo është konfirmuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin e Latif Gashi *e të tj*⁷. Sipas nenit 3 paragrafit 2 të KPRK-së, në rast të një ndryshimi në ligjin e zbatueshëm për një çështje të caktuar para vendimit përfundimtar do të zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin e veprës.

Lidhur me krimet e kryera në Shqipëri

10. Sipas nenit 106 të KP i RSFJ-së, ligji penal jugosllav zbatohet për një qytetar të RSFJ-së (Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë), kur jashtë vendit ai kryen një vepër penale përveç atyre të përmendura në nenin 105 të këtij ligji, me kusht që ai është gjetur në territorin e RSFJ-së ose është ekstraduar në RSFJ.
11. Neni 142 nuk është i përmendur në nenin 105 të KP i RSFJ-së, por i pandehuri **Xh.K.** ishte gjetur në tetor 2015 në territorin e Kosovës, e cila në kohën e ngjarjeve ishte pjesë e RSFJ-së.

⁷ UNMIK Gjykata Supreme, *Latif Gashi e të tj.* (AP-KZ 139/2004), Vendim, 21 korrik 2005, f. 5

Kështu, në pajtim me nenin 106, KP i RSFJ-së zbatohet për veprat penale sipas nenit 142 të kryera nga i pandehuri jashtë Kosovës.

12. KPRK-ja aktuale, neni 115, parasheh zbatimin e ligjeve penale të Kosovës për çdo person i cili kryen vepra penale jashtë territorit të Republikës së Kosovës siç janë përmendur në nen. Neni 152 i KPRK-së është një prej neneve të përmendura në nenin 115 paragrafi 1. Prandaj, zbatimi i dispozitave përkatëse të KPRK-së do të jepnin të njëjtin rezultat.

II.2 Ligji i aplikueshëm procedural

13. Pasi që Aktakuza ishte ngritur pas hyrjes në fuqi të KPP-së, në bazë të nenit të saj 545 paragrafi 1, ligji procedural i zbatueshëm për këtë rast është KPP.

III JURIDIKSIONI

III.1 Juridiksioni lëndor

14. Në përputhje me nenin 20 të KPP-së, i lexuar së bashku me nenin 11 të Ligjit mbi Gjykatat⁸, gjykata themelore është kompetente për të gjykuar këtë rast në shkallën e parë.

III.2 Kompetenca territoriale

15. Në përputhje me nenin 35 paragrafi 3 i KPP-së, si rregull, të bashkëpandehurit i nënshtrohen kompetencës së gjykatës e cila ka kompetencë për njërin prej tyre dhe në të cilën së pari është ngritur aktakuza.

16. Në këtë rast, aktakuza kundër S. G. dhe të tjerëve, të cilët janë hetuar për të njëjta fakte është ngritur në Gjykatën e (atëhershme) të Qarkut të Mitrovicës me 6 gusht 2010. Prandaj, Gjykata Themelore e Mitrovicës është kompetente për të dëgjuar rastin kundër të pandehurit **Xh. K.**

Kompetenca e gjyqtarëve të EULEX-it dhe përbërja e trupit gjykues

⁸ Ligji nr. 03/L-199

17. Më 10 nëntor 2015, pas një kërkesë nga Njësia e Gjyqtarëve të EULEX-it, dhe në bazë të Ligjit nr. 04 / L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës dhe në bazë të Marrëveshjes së datës 18 qershor 2014 ndërmjet shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në aspektet përkatëse të bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarë që punojnë në gjykatat lokale ("Marrëveshja"), ushtruesi i detyrës së kryetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës ia ka caktuar rastin një gjyqtari të EULEX-it, si kryetar i trupit gjykues.
18. Një shkëmbim i letrave mbi vazhdimin e mandatit të EULEX-it, i cili duhej të përfundonte më 15 qershor 2016 u zhvillua në mes të Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian me 9 dhe 15 qershor 2016. Ligj për Ratifikimin e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare (Ligji nr .05-L-102) dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës janë miratuar nga Kuvendi më 17 qershor 2016 dhe ka hy në fuqi më 29 qershor 2016.
19. Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, neni 15, paragrafi 2 i Ligjit për Gjykatat thekson se rasti duhet të shqyrtohet nga një trup gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë.
20. Është një fakt i njohur që nga marsi 2008 deri në ditën e marrjes së aktgjykimit, për shkak të kërkesave specifike të sigurisë në veri të Mitrovicës, ka ekzistuar një praktikë e vendosur në mënyrë të fuqishme që rastet penale në Gjykatën Themelore të Mitrovicës të gjykohen nga trupe gjykuese të përbëra ekskluzivisht nga gjyqtarët e EULEX-it. Një praktikë e tillë u ripohua në Marrëveshjen e lartpërmendur, ku sipas nenit 5 (a), thuhet se "Gjyqtarët e EULEX-it do të sigurojnë që Gjykata Themelore e Mitrovicës do të veprojë derisa sistemi gjyqësor multi-etnik në veri të zbatohet dhe të veprojë".
21. Fillimisht rasti i është caktuar gjyqtarit të EULEX-it Vidar STENSLAND si kryetar i trupit gjykues, i cili e kryesoi fazën e dëgjimit fillestar. Për shkak të arsyeve të brendshme, me vendimin e datës 17 shkurt 2016 të zyrës së Presidencës së Gjyqtarëve të EULEX-it, vendi i kryetarit të trupit gjykues i ishte caktuar më pas gjyqtarit të EULEX-it Katrien Gabriel

Witteman. Anëtarët e trupit gjykues ishin gjyqtarët e EULEX-it Iva Nikshiq dhe René van Veen. Nuk ka pasur asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

IV SHQYRTIMI GJYQËSOR

22. Seancat e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur më 18 mars 2016, 11, 12, 13, 18, 19, 20 dhe 25 prill 2016, 13, 23, 24, 25 dhe 30 maj 2016, 7, 8, 12, 14 korrik 2016 dhe 2 dhe 4 gusht 2016. Ato ishin të gjitha të hapura për publikun. Publiku u përjashtua vetëm gjatë verifikimit të identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur, për të garantuar respektimin e Urdhrave për vendosjen e masave mbrojtëse për Dëshmitarët.
23. Gjatë hapjes së seancës të datës 18 mars 2016, prokurori tërhoqi pikën e shtatë të akuzës për krime të luftës kundër popullatës civile, domethënë pikën e Shkeljes së Integritetit trupor apo Shëndetit si Krim Luftë në lidhje me një individ të panjohur nga Pre., në C. (në veri të Shqipërisë) në një datë të panjohur në maj ose qershor të vitit 1999.
24. Në të njëjtën seancë të datës 18 mars 2016, i akuzuari u deklarua i pafajshëm për akuzën e krimeve të luftës në të gjitha gjashtë pikat e mbetura, ndërsa ai e ka konfirmuar pranimin e fajit për veprën mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Trupi Gjykues pastaj mori vendimin për t'u marrë me pikën e tërhequr të aktakuzës dhe për pranimin e veprës penale " Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" në aktgjykimin e formës së prerë.

V PROVAT DHE CILËSIMI JURIDIK

V.1 Provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor

25. Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitarët në vijim.

Dëshmitarët e prokurorisë:

- (1) Dëshmitari B me 11 prill 2016
- (2) Dëshmitari D me 13 prill 2016
- (3) Dëshmitari E me 13 prill 2016
- (4) Dëshmitari F me 18 prill 2016
- (5) Dëshmitari I.I. (ish Dëshmitari L) me 20 prill 2016

- (6) Dëshmitari H me 25 prill 2016
 - (7) Dëshmitari I me 13 maj 2016
 - (8) Dëshmitari J me 23 maj 2016
 - (9) Dëshmitari K me 24 maj 2016
 - (10) Dëshmitari M me 25 maj 2016
 - (11) Dëshmitari A. I. (ish Dëshmitari 1) me 30 maj 2016
 - (12) Dëshmitari Ru. S. (ish Dëshmitari 2) me 7 korrik 2016
 - (13) Dëshmitari O. H. (ish Dëshmitari 3) me 7 korrik 2016
26. Dëshmitari G u paraqit në seancën e datës 19 prill 2016, por nuk ka mundur të dëshmojë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

Dëshmitarët e mbrojtjes:

- (1) Dëshmitari A. P. me 8 korrik 2016
 - (2) Dëshmitari B. P. me 8 korrik 2016
 - (3) Dëshmitari N. B. me 12 korrik 2016
 - (4) Dëshmitari A. H. me 12 korrik 2016
27. Me 14 korrik 2016 ishte dëgjuar i pandehuri.
28. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, provat materiale në vijim u lexuan në procesverbal.
- (1) Procesverbali i prokurorisë mbi dëgjimin e dëshmitarit të Dëshmitarit C të datës 17 dhjetor 2009, i pranuar më 11 prill 2016⁹
 - (2) Raporti i NJHKL të Policisë së EULEX-it mbi deklaratën e marrjes në pyetje të Dëshmitarit C të datës 9 prill 2009, e pranuar më 11 prill 2016¹⁰
 - (3) Certifikata e vdekjes të Dëshmitarit A, e paraqitur nga prokurori dhe e pranuar me 23 maj 2016¹¹
 - (4) Procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarit të dëshmitarit N më 10 dhe 16 mars 2010, e pranuar më 24 maj 2016¹²
 - (5) Procesverbali për dëgjimin e Dëshmitarit në një hetim paraprak të Dëshmitarit N të datës 2 dhjetor 2010, e pranuar me 24 maj 2016¹³

⁹ Regjistratori i Prokurorisë C2, fashikulli 2, f. 179-210

¹⁰ Regjistratori i Prokurorisë C2, fashikulli 2, f. 211-235

¹¹ Regjistratori i Gjykatës III, fashikulli 2

¹² Regjistratori i Prokurorisë D, fashikulli 4, f. 356-494

¹³ Regjistratori i Prokurorisë D, fashikulli 4, p. 495-508

(6) Procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor të S. G. e të tj. të datës 23 dhe 25 maj 2011 përmbajnë dëshminë e dëshmitarit të Dëshmitarit N, e pranuar më 24 maj 2016¹⁴

(7) Raporti i ekzaminimit fizik të Dëshmitarit B, i paraqitur nga prokurori dhe e pranuar më 12 korrik 2016¹⁵

(8) Certifikata e vdekjes të Dëshmitarit 5, e pranuar më 14 korrik 2016¹⁶.

29. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 2 gusht 2016, lista e provave materiale të paraqitura nga prokurori është pranuar dhe administruar¹⁷.

30. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, pjesët e mëposhtme të provave u ekspozuan nga Gjykata.

(1) Prova 1, një zmadhim i një fotoje të marrë nga shkresat e lëndës nga prokurori, i është treguar Dëshmitarit I më 13 maj 2016¹⁸

(2) Prova 2, një fotografi e gjetur nga prokurori duke kërkuar në internet emrin e të pandehurit **Xh. K.**, i është treguar Dëshmitarit Ru. S. më 7 korrik 2016 dhe Dëshmitarit B. P. më 8 korrik 2016¹⁹.

V.2 Pranueshmëria e provave

31. Me përjashtim të procesverbalit të marrjes në pyetje të dëshmitarit K të datës 21 prill 2010, i cili ishte përjashtuar nga shkresat e lëndës nga Trupi Gjykses në aktvendimin e saj me gojë të datës 24 maj 2016 siç shtjellohet më poshtë nën § 60, të gjitha provat e paraqitura nga prokurori konsiderohen si prova të pranueshme.

V.3 Urdhrat dhe vendimet procedurale dhe të provave

32. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka ndërmarrë këto veprime procedurale ose sipas detyrës zyrtare ose nga propozimet e parashtruara nga palët.

¹⁴ Regjistratori i Prokurorisë I, fashikulli 5-6, p. 343-509

¹⁵ Regjistratori i Gjykatës IV, fashikulli 6

¹⁶ Regjistratori i Gjykatës IV, fashikulli 5

¹⁷ Regjistratori i Gjykatës IV, fashikulli 5

¹⁸ Regjistratori i Gjykatës III, fashikulli 5

¹⁹ Regjistratori i Gjykatës IV, fashikulli 8

Urdhri i gjykatës i datës 17 mars 2016 për Masat për të mbrojtur palët e dëmtuara dhe disa dëshmitarë

33. Më 17 mars 2016, Gjykata ka lëshuar një urdhër për masat për të mbrojtur palët e dëmtuara dhe disa dëshmitarë të caktuar, lejimin e masave mbrojtëse në bazë të nenit 222 të KPP-së për Dëshmitarët e propozuar nga Prokuroria dhe të përmendura në Shtojcën Konfidenciale të bashkangjitur në aktakuzë.
34. Në urdhrin e saj, Gjykata ritheksoi masat mbrojtëse të pseudonimeve të caktuara për Dëshmitarë dhe anonimitetin e tyre nga publiku, të vendosura në urdhrin e saj të datës 31 gushtit 2010 në lëndën penale të *S. G. e të tj P* nr 45/10, duke përfshirë detyrimin e mëvonshëm për avokatët mbrojtës për të mos zbuluar identitetin apo çfarëdo të dhëne ose informate që mund të përdorey për të identifikuar Dëshmitarët.

Urdhri i gjykatës i datës 24 Mars 2016 mbi Propozimin e Prokurorisë për masa shtesë për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë dhënies së provave

35. Gjatë hapjes së seancës së datës 18 mars të vitit 2016, prokurori paraqiti një propozim me titull "Provat që do të jepen nga të gjithë Dëshmitarët nëpërmjet video-lidhjes në një vend të largët dhe aplikimi i ndryshimit të zërit vetëm për Dëshmitarin C", në bazë të nenit 222 paragrafi. 1, nën paragrafi 1.3 i KPP-së. Prokurorja në propozimin e saj i është referuar obligimit në pritje për të garantuar respektimin e urdhrin të gjykatës që tashmë i kishte lejuar masa mbrojtëse dëshmitarëve B, C, D, E, F, G, H, I, J, K, L, M dhe N, dhe nevoja për t'i dëgjuar ata në një mënyrë që identiteti i tyre të mos shfaqej në media dhe publikut të pranishëm në sallën e gjyqimit. Prokurori më tej ka kërkuar që çdo formë e audio ose video incizimit të ndalohet. Në lidhje me Dëshmitarin C, Prokurori ka kërkuar zbatimin e masës plotësuese të shtrembërimit të zërit.
36. Mbrojtja ka kundërshtuar propozimin duke argumentuar se Dëshmitarëve në fjalë kurrë nuk iu kishte drejtuar dhe kurrë nuk ka pasur incidente të zbulimit të identitetit të tyre për dikë. Avokati mbrojtës pastaj paraqiti se kërkesa e prokurorit ishte në kundërshtim me frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe me nenet 7 dhe 9 të KPP-së, pasi që duke mos i lejuar Mbrojtjes të sfidojë Dëshmitarët në gjykatë të hapur dhe për të analizuar dhe vlerësuar drejtpërdrejt sjelljet e fytyrës dhe reagimet emocionale të dëshmitarëve, barazia

e armëve do të minohej, që ndikon në paanshmërinë e provës dhe vlerësimit të saj. Avokati mbrojtës shtoi se, pasi që e drejta për gjykim publik, do të ndikohet gjithsesi, Prokurori ka mund të kërkojë që në vend të kësaj publiku të përjashtohet.

37. Më 24 mars 2016, Gjykata lëshoi një urdhër që lejonte propozimin e Prokurorisë. Gjykata ka vlerësuar nevojën për të arritur një ekuilibër të drejtë midis vlerave të mbrojtura me të drejtën për një gjykim publik, të drejtën për mbrojtje dhe barazi të palëve në njërin anë dhe të drejtën e dëshmitarëve për sigurinë e tyre personale në anën tjetër. Gjykata mendoi se në të vërtetë balanca e tillë mund të arrihej me autorizimin e dëshmitarëve për tu dëgjuar në modalitetet e kërkuara nga prokurori pasi që, duke marrë parasysh natyrën e sofistikuar të pajisjeve të video-linkut, mbrojtja do të jetë në gjendje të angazhohet në ndonjë marrje të tërthortë në pyetje duke përdorur prova demonstrative apo duke i paraqitur dokumente Dëshmitarit për përdorim dhe sjellja e tyre e fytyrës do të ishte e dukshme për mbrojtjen dhe Gjykatën gjatë gjithë kohës. Përveç kësaj, e drejta për një gjykim publik mund të ruhet duke i lejuar mediat dhe publikun për të qëndruar në sallën e gjyimit gjatë dëshmisë, dhe për të dëgjuar (por jo parë) Dëshmitarët.

Urdhrat e Gjykatës të datës 12 dhe 13 prill 2016 për Asistencë Policore në detyrimin e Dëshmitarit B të paraqitet në Gjykatë

38. Dëshmitari B është thirrur të paraqitet në Gjykatë më 11 dhe 12 prill 2016. Dëshmitari u paraqit në Gjykatë më 11 prill 2016 dhe filloi duke e dhënë dëshminë e tij përmes video-lidhjes nga një vend i largët. Pasi që prokurori nuk e kishte mbaruar marrjen në pyetje të Dëshmitarit në fund të ditës, atij iu tha që të kthehej të nesërmen, më 12 prill 2016, për të përfunduar dëshminë e tij. Megjithatë, më 12 prill 2016 Dëshmitari nuk u paraqit. Në të njëjtën ditë, Gjykata lëshoi një urdhër për Asistencë Policore në detyrimin e Dëshmitarit për t'u paraqitur në gjykatë, por pa dobi. Më 13 prill 2016, Gjykata lëshoi një urdhër tjetër bindës, por përsëri pa dobi. Marrja në pyetje e Dëshmitarit nuk ka mund të përfundohet dhe asnjë marrje e tërthortë në pyetje nuk ka mund të bëhet.

Aktvendimi i gjykatës të datës 14 prill 2016 mbi Propozimin e Prokurorit për heqjen e masave mbrojtëse

39. Më 11 prill 2016, prokurori paraqiti një kërkesë për heqjen e masave mbrojtëse të vendosura ndaj Dëshmitarit L dhe Dëshmitarëve 1, 2 dhe 3 duke ndryshuar urdhrat e gjykatës të datës 17 dhe 24 mars 2016 dhe duke i lejuar ata që të zbulojnë identitetin e tyre dhe për të dëshmuar në gjykim të hapur. Prokurori pohoi se këta Dëshmitarë kanë shprehur vullnetin e tyre për të dëshmuar drejtpërdrejt në gjykim të hapur pa masa të mëtejshme të vendosura për të mbrojtur identitetin e tyre.
40. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 13 prill 2016, prokurori plotësoi Kërkesën me gojë, duke kërkuar të njëjtat ndryshime për Dëshmitarin B.
41. Mbrojtja as nuk e ka mbështetur e as nuk e ka kundërshtuar kërkesën.
42. Më 14 prill 2016, Gjykata ka lëshuar një aktvendim, duke e lejuar kërkesën e prokurorit në lidhje me dëshmitarët L, 1, 2 dhe 3, dhe duke e refuzuar atë në lidhje me Dëshmitarin B. Dallimet thelbësore në bazë të vendimit të Gjykatës janë përpunuar si më poshtë. Dëshmitarët L, 1, 2 dhe 3 drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të qartë kanë shprehur vullnetin e tyre për të dëshmuar në gjykim të hapur. Nga ana tjetër, në lidhje me Dëshmitarin B, Gjykata ka vlerësuar se nëse eventualisht dëshmitari paraqitet para Gjykatës, duke ndryshuar *modus* në të cilën dëshmia e tij ishte marrë deri atëherë, pra nëpërmjet video-linkut dhe me një pseudonim, kjo në thelb mund të ndikojë në barazinë e armëve. Përveç kësaj, arsyet për të marrë parasysh zhdukjen e papritur të Dëshmitarit, Gjykata nuk ka mund të përjashtojë që Dëshmitari me të vërtetë ka mundur të ketë qenë në një formë të presionit apo kërcënimeve dhe, për këtë arsye, masat e shqiptuara ishin ende të nevojshme.

Urdhri i Gjykatës së datës 21 prill 2016 për Vlerësimin Mjekësor të Dëshmitarit G

43. Më 19 prill 2016, Dëshmitari G u shfaq në vendin e caktuar të largët për të dëshmuar para Gjykatës. Megjithatë, para fillimit të dëshmisë së tij, kushtet shëndetësore të Dëshmitarit u përkeqësuan deri në një pikë që ai u dashtë të largohet nga ai vend i largët. Prandaj, dëshmia e tij nuk ka mund të dëgjohet.
44. Më 21 prill 2016, Gjykata ka lëshuar një urdhër për vlerësimin mjekësor, duke emëruar një ekspert mjekësor për të kryer një ekzaminim personal të Dëshmitarit dhe për ti ofruar

Gjykatës një vlerësim nëse Dëshmitari mundet në mënyrë psikike dhe fizike të marrë pjesë në një seancë gjykimi dhe të jap dëshminë.

45. Më 9 maj 2016, Gjykata pranoi raportin mjekësor. Eksperti vendosi që Dëshmitari vuan nga çrregullimi mendor i *Skizofrenisë paranoide*, se sëmundja kishte një zhvillim kronik të natyrës së përhershme dhe me një intensitet të psiko-simptomatologjisë që ndryshon nga e moderuara tek e rënda, dhe se intervalet e qarta ishin tepër të rralla ose plotësisht mungojnë. Eksperti arriti në përfundimin se, për shkak të natyrës së çrregullimit, dhe veçanërisht gjendjes aktuale psikike dhe fizike të dëshmitarit, ai nuk mund të marrë pjesë në një procedurë gjyqësore. Raporti mjekësor i është dhënë palëve gjatë seancës gjyqësore të datës 13 maj 2016.

Aktvendimi i Gjykatës së datës 7 korrik 2016 mbi Mbështetjen e Pohimit të Prokurorit për Vërtetimin e Dëshmitarit A dhe kërkesën për të dëgjuar Dëshmitarin G nga shtëpia e tij, ose që deklaratat e tij të konsiderohen si të lexuara

Për Dëshmitarin A:

46. Gjatë seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor më 18 mars 2016, prokurori paraqiti Mbështetjen e Pohimit në pajtim me nenin 263 të lexuar së bashku me nenin 219 paragrafi 6 dhe 243 paragrafi 2 i KPP-së në lidhje me Dëshmitarin A, duke argumentuar se më 15 shkurt 2016 Zyra e Prokurorisë është bërë e vetëdijshme se Dëshmitari A, deklaratat e të cilit duhet të konsiderohen relevante për rastin, kishte ndërruar jetë. Mbështetja e kërkuar e pohimit do të lejoj Prokurorin të paraqes dhe të mbështetet në deklaratat e dhëna më parë nga Dëshmitari. Në veçanti, Prokurori kërkoi mundësinë për t'u mbështetur në deklaratat e Dëshmitarit të dhëna për Policinë e EULEX-it më 10 gusht 2009, 24 gusht 2009 dhe 15 Dhjetor 2009, dhe në Deklaratën e dhënë nga Dëshmitari për Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë (TNPJ) me 17-18 dhe 19 janar 2003.
47. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 12 prill 2016, avokati mbrojtës kundërshtoi propozimin duke argumentuar se deklaratat nuk mund të pranohen dhe të mbështetemi në to pasi që Mbrojtja nuk ka pasur mundësi që të kundërshtojë provat e dhëna nga Dëshmitari A në ndonjë fazë të procedurës dhe një aktgjykim kurrë nuk duhet të bazohet në fakte ose prova që nuk mund të sfidohen nga të dyja palët.

48. Gjykata, në aktvendimin e saj me gojë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 7 korrik të vitit 2016²⁰, ka vlerësuar se pohimi i Prokurorisë është paraqitur me kohë, dhe se kërkesat e tjera të nenit 263 të KPP-së janë plotësuar në mënyrë të barabartë. Prandaj, pohimi është pranuar nga Gjykata si i afatshëm dhe i paraqitur në mënyrë të rregullt. Megjithatë, Gjykata ka vu në dukje se neni 263 paragrafi 1 i referohet nenit 261, i cili i referohet përsëri nenin 123 paragrafit 2 dhe 3 të KPP-së. Gjykata vlerësoi se, pasi që Mbrojtja në të vërtetë nuk ka pasur mundësi të marrë tërthorazi në pyetje Dëshmitarin në ndonjë fazë të procedurës, deklaratat e dhëna nga Dëshmitari A tek autoritetet e EULEX-it (Policia dhe Prokurori) ose në TNPJ duhet të konsiderohen si "marrje në pyetje e dëshmitarit", siç thuhet në nenin 131 të KPP-së që në bazë të nenit 123 paragrafi 2 i KPP-së, nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë aktgjykimin.

Për Dëshmitarin G:

49. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 30 maj të vitit 2016, pas marrjes së raportit për vlerësimin mjekësor të Dëshmitarit G, Prokurori i propozoi Gjykatës për të dëgjuar Dëshmitarin G sipas procedurës së përshkruar në nenin 343 të KPP-së, duke e lejuar atë që të dëshmojë prej shtëpisë së tij në prani ose të kryetarit të trupit gjykues ose gjyqtarit të trupit gjykues. Prokurori argumentoi se, sipas raportit mjekësor, Dëshmitari ishte diagnostikuar me skizofreni paranoide më 8 janar 2010, por se më 4 mars 2010 ai kishte dhënë një deklaratë para prokurorit e cila ishte koherente dhe e qartë, dhe ku Dëshmitari ishte në gjendje për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të tij. Kjo deklaratë u përdor më vonë nga Trupi Gjyqësor në gjykimin kundër S. G. e të tjerë. (në tekstin e mëtejshëm: "Gjykimi i G."), edhe pse Dëshmitari nuk ka dëshmuar para asaj Gjykate. Për këtë arsye, prokurori ka kërkuar që të zbatohet neni 343 i KPP-së. Si shtesë, prokurori ka kërkuar nga Gjykata që të konsideroj deklaratat e dëshmitarit si të lexuara.

50. Mbrojtja ka kundërshtuar propozimin, duke argumentuar se raporti mjekësor ishte i qartë në përfundimin se Dëshmitari nuk mund të marr pjesë në procedurën penale. Pra, çdo dëshmi eventuale që do të merrej nga Dëshmitari *a priori* do të ishte e pabesueshme dhe e dyshimtë.

²⁰ Certifikata e Vdekjes së Dëshmitarit A i ishte ofruar gjykatës me 23 maj 2016.

51. Gjykata, në aktvendimin e saj me gojë të datës 7 korrik 2016 pohoi se nuk mund të devijojë nga përfundimi i ekspertizës mjekësore që ishte urdhëruar dhe kryer lidhur me Dëshmitarin G, dhe e cila në mënyrë të qartë përmend pamundësinë e Dëshmitarit që të marr pjesë në procedurat gjyqësore dhe në këtë mënyrë duke përfshirë çfarëdo dëshmie që të merret në vendbanimin e tij. Prandaj, Gjykata hodhi poshtë kërkesën e prokurorit.
52. Në lidhje me propozimin për të lexuar deklaratën e Dëshmitarit G në procesverbal, Gjykata vërejtë se neni 338 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i KPP-së lejon që procesverbali që përmban deklarinimin e Dëshmitarëve të lexohet *ndër të tjera*, në qoftë se personi që i cili është marrë në pyetje vuan nga çrregullime mendore. Megjithatë, edhe një herë duhet bërë dallim në mes të marrjes në pyetje të dëshmitarit, siç thuhet në nenin 131 dhe marrjes së deklaratës së dëshmitarit, siç kuptohet në nenin 13 dhe përdorimin e tyre të ndryshëm më vonë si prova në bazë të nenit 123 paragrafët 2 dhe 3 të KPP-së. Pasi që në këtë rast Mbrojtja nuk kishte asnjë mundësi që të marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë Dëshmitarin G gjatë fazës së procedurës paraprake, marrjet në pyetje të Dëshmitarit duhet të konsiderohen si "marrje të deklaratave", dhe si të tilla ato nuk bien nën përkufizimin e nenit 338 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i KPP-së, e cila në mënyrë të qartë i referohet 'dëshmisë'.

Aktvendimi i gjykatës i datës 26 Korrik 2016 lidhur me Kërkesën e Prokurorit që të lexohen në Gjykatë deklaratat e procedurës paraprake dhe shqyrtimit gjyqësor të Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit 5

53. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 7 korrik 2016, prokurori paraqiti një propozim që të lexohen në procesverbal deklaratat e procedurës paraprake dhe shqyrtimit gjyqësor të Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit 5, në përputhje me nenin 338 të KPP-së. Prokurori argumentoi se të dy dëshmitarët kishin vdekur, që sjell zbatueshmërinë e nenit 338 të KPP-së dhe, në këtë mënyrë, mundësinë që të lexohen deklaratat e tyre në procesverbal. Prokurori më tej argumentoi se fjala 'deklarim' e përfshirë në paragrafin 1 të nenit 338 duhet të kuptohet në kuptimin e saj më të gjerë, duke përfshirë të gjitha " deklaratat' e dhëna para prokurorit nga Dëshmitari. Do të ishte kundër qëllimit të ligjvënësit që fjala 'deklarim', të interpretohet në mënyrë të rreptë. Për më tepër, titulli i vet nenit i referohet 'deklaratave', e jo 'dëshmive'.

54. Avokati mbrojtës në përgjigjen e tij me gojë ka kundërshtuar propozimin, duke argumentuar se në asnjë fazë të procedurës mbrojtësit nuk i është dhënë mundësia që të marrë në pyetje të tërthortë këta dëshmitarë prandaj leximi i deklaratave të tyre do të ishte i paligjshëm. Në të njëjtën kohë, Mbrojtja ka kërkuar që të gjitha deklaratat e të dyve, Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit 5 në gjykimin e G., pa marrë parasysh a janë ato marrje në pyetje apo dëshmi, të shpallen si prova të papranueshme.
55. Në aktvendimin e saj të datës 26 korrik 2016, Gjykata ka përsëritur dallimin e brendshëm në mes të marrjeve në pyetje të Dëshmitarit dhe deklaratave të Dëshmitarit sipas neneve 131 dhe 132 të KPP-së. Gjykata iu referua aktvendimit të saj të lëshuar më 7 korrik 2016, ku në mënyrë të qartë theksoi se të gjitha deklaratat e dhëna nga Dëshmitari A do të konsiderohen si "marrje në pyetje" me qëllim të KPP-së. Prandaj, Gjykata vlerësoi se deklaratat e dhëna nga Dëshmitari 5 duhet të konsiderohen në mënyrë të barabartë si " marrje në pyetje ", pasi që mbrojtja e **Xh. K.** asnjëherë nuk ka pasur mundësi që ta marrë në pyetje të tërthortë. Prandaj, përdorimi i këtyre intervistave si provë e drejtpërdrejtë është e ndaluar nga rregullat që parashihen në nenin 123 paragrafi 2 i KPP-së.
56. Gjykata më pas vlerësoi nëse Titulli i nenit 338 të KPP-së do të çonte deri tek një interpretim i "dëshmive" si deklarata, duke përfshirë të dyja, dëshmitë dhe marrjet në pyetje, siç mbështetet nga Prokurori. Gjykata megjithatë e hodhi poshtë këtë interpretim në funksion të faktit se titujt nuk konsiderohen si pjesë përbërëse e vetë Kodit, por janë shtuar vetëm për të lehtësuar përdorimin e tij.
57. Gjykata refuzoi si të pabazuar propozimin e mbrojtjes për shpalljen e deklaratave të Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit 5 si të papranueshme, duke pasur parasysh se papranueshmëria e deklaratave nën KPP është e rregulluar në mënyrë shteruese në nenin 128 dhe nenin 249 paragrafi 1 i KPP-së, dhe asnjë nga rrethanat e radhitura në këto dispozita nuk zbatohen për deklaratat e dëshmitarëve.

Aktvendimi i gjykatës të datës 24 Maj 2016 mbi Propozimin e Mbrojtjes për të shpallur të papranueshme deklaratën e panënshkruar të Dëshmitarit K të datës 21 Prill 2010

58. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 24 maj 2016, avokati mbrojtës gjatë marrjes në pyetje kundërshtoi përdorimin e deklaratës së dhënë nga Dëshmitari K më 21 prill 2010, pasi

që as versioni në gjuhën angleze e as ai në gjuhën shqipe nuk e kishin asnjë nënshkrim të Dëshmitarit.²¹ Prandaj, mbrojtja ka kërkuar që deklarata të shpallet e papranueshme.

59. Prokurori u përgjigj se propozimi ishte i paafatshëm, pasi Mbrojtja kishte pasur një mundësi për të kundërshtuar pranueshmërinë e çfarëdo prove në fazën e dëgjimit fillestar. Të gjitha provat pastaj janë deklaruar si të pranueshme.
60. Gjykata nuk e ka konstatuar propozimin si të paafatshëm dhe u pajtua me mbrojtjen që, në bazë të nenit 207 paragrafit 2 të KPP-së, procesverbalet e marrjes në pyetje në të vërtetë duhet të nënshkruhen nga personi i cili është marrë në pyetje. Rëndësia e kësaj dispozite është ripohuar me faktin se neni 207 paragrafi 9 i KPP-së përcakton qartë se " Kur personi (...) kundërshton ta nënshkruajë (..) kjo do të shënohet në procesverbal së bashku me shkaqet e refuzimit." Pasi që asnjëri version i deklaratës së dëshmitarit nuk ka nënshkrim, Gjykata konsideron se deklarata e datës 21 prill 2010 nuk i plotëson kërkesat zyrtare të KPP-së , dhe duke pasur parasysh rëndësinë që një Dëshmitar të nënshkruajë deklaratat e tij si një dëshmi se ai pajtohet me përmbajtjen e saj, Gjykata e shpalli atë si provë të papranueshme dhe e ka përjashtuar nga shkresat e lëndës.

V.4 Vlera provuese e provës

Dëshmitarët A, G dhe 5

61. Në aktvendimet e saj të ndryshme gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, siç u përmend më lart, trupi gjykues ka theksuar se duhet të bëhet një dallim i qartë në mes të pranueshmërisë së provës (nenet 249 dhe 259 të KPP-së) dhe në përdorimin e saj si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke përfshirë aktgjykimin (nenet 261 dhe 262 të KPP-së).
62. Përfundimi ishte se, edhe pse neni 262 i KPP-së duket se lejon përdorimin e provave të cilat nuk mund të kundërshtohen nga mbrojtja si bazë për një dënim për aq kohë sa ajo nuk është 'e vetme apo vendimtare "neni 261, me referencën e tij për nenin 123 të KPP-së, plotësisht përjashton përdorimin e saj, duke lejuar vetëm dëshmitë e procedurës paraprake (që do të

²¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f.19 prej 41

thotë marrjen në pyetje të dëshmitarit të cilën mbrojtja nuk ka pasur mundësinë ta sfidojë) si bazë për dënim, edhe pse nuk është e vetme apo vendimtare.

63. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk i ka lejuar deklaratat e Dëshmitarëve A, G dhe 5 të lexohen në bazë të nenit 338 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i KPP-së, dhe ai nuk mund të përdor këto deklarata si prova të drejtpërdrejtë në aktgjykimin e saj. Kjo nuk ndryshohet nga fakti se, për Dëshmitarin A, një mbështetje e pohimit ishte paraqitur në mënyrë të duhur dhe në kohën e duhur nga prokurori dhe ishte pranuar nga Gjykata.

Dëshmitari B

64. Dëshmitari B, për arsye të panjohura në Gjykatën, u zhduk para se Prokurori të kishte përfunduar marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje. Pavarësisht përpjekjeve të Gjykatës dhe Prokurorisë, Dëshmitari nuk është paraqitur sërish para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, duke mos i dhënë mbrojtjes asnjë shans për të marrë në pyetje atë. Për këtë arsye, nëpërmjet zbatimit analog të nenit 123 paragrafi 2 i KPP-së, Gjykata konstaton se procesverbali i shqyrtimit gjyqësor që përmban marrjen e tij të drejtpërdrejtë në pyetje (të papërfunduar) nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë. Për të njëjtën arsye, deklaratat e procedurës paraprake të Dëshmitarit B, duhet të ndajnë të njëjtin fat.

Dëshmitari C dhe Dëshmitari N

65. Në përputhje me nenin 338 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 i KPP-së, marrja e drejtpërdrejtë në pyetje e Dëshmitarit mund të zëvendësohet me leximin e procesverbalit të marrjes së tij të mëparshme në pyetje, nëse palët bien dakord.
66. Dikush mund të thotë se ky nën-paragraf nuk mund të lexohet veçmas nga paragrafi 1 i nenit 338, i cili në mënyrë të qartë i referohet 'dëshmisë'. Kjo do të thotë se procesverbalet e marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit nuk mund të lexohen, ose të konsiderohen si të lexuara, edhe në qoftë se palët janë pajtuar. Megjithatë, është mendimi i trupit gjykues se përdorimi i ligjvënësve të fjalës "marrje në pyetje" në nën paragrafin 1.3, në vend të "dëshmisë" në paragrafin 1, favorizon një interpretim që është më shumë në përputhje me frymën e KPP-së dhe ku marrëveshja e palëve duhet të shihet si një përjashtim nga e drejta e tyre për të marrë në pyetje dhe për të marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë dëshmitarin.

Duke e ndjekur këtë interpretim më shumë sistematik sesa gramatikor, trupi gjykues konstaton se procesverbalet e marrjes së pyetje të Dëshmitarit C dhe Dëshmitarit N, të cilat palët kanë rënë dakord që ti konsiderojnë si të lexuara mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë, dhe do të shërbejë si bazë për një dënim me kusht që nuk janë të 'vetme apo vendimtare'".

V.5 Besueshmëria e dëshmitarëve

Masa mbrojtëse dhe provat e dëgjura nëpërmjet video-lidhjes

67. Siç u diskutua më lart në § 37, vendimi i Trupit Gjykues të vendosë masa mbrojtëse në bazë të nenit 222 të KPP-së, duke përfshirë edhe vendimin për të dëgjuar Dëshmitarët nëpërmjet video-lidhjes ishte rezultat i balancimit të interesave, ku në anën njëra anë është marrë në konsideratë siguria e dëshmitarëve duke u fshehur identitetin e tyre nga publiku dhe shtypi, dhe në anën tjetër shkelja e paevitueshme e së drejtës së palës ishte e kufizuar në minimum duke i lejuar ata të dy të dëgjojnë dhe shohin dëshmitarët, dhe të jenë të pranishëm gjersa të dhënat e tyre personale ishin verifikuar.
68. Trupi Gjykues nuk sheh asnjë arsye të besojë, dhe në fakt kjo nuk është argumentuar nga asnjëra palë, që masat mbrojtëse kanë ndikuar në ndonjë mënyrë në besueshmërinë e deklaratave të Dëshmitarëve.

Takimet me Prokurorin para dëshmisë në Gjykatë

69. Pas shpalljes së këtij aktgjykimi më 8 gusht 2016, në një interpretim të shkurtër të arsyeve të dhëna gojarisht, Trupi Gjykues ka shprehur shqetësimin e saj në lidhje me takimet që u zhvilluan në mes të Prokurorit dhe Dëshmitarëve para marrjes së tyre në pyetje në gjykatë.
70. Si rregull, palët duhet të përmbahen nga veprimet me të cilat – me dëshirë ose pa dëshirë - mund të ndikojnë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Nëse një prokuror e sheh të nevojshme për të përgatitur një dëshmitar për marrjen e tij në pyetje në gjykatë, kjo duhet të ndodhë në mënyrë transparente, në mënyrë që të mund të verifikohet nëse informacioni përkatës i është transmetuar dëshmitarit. Çdo dyshim në këtë drejtim, i bazuar apo jo, lehtë

mund të kundërshtohet duke mbajtur procesverbal të takimeve dhe duke i ndarë ato me gjykatën dhe mbrojtjen.

71. Në këtë rast megjithatë, edhe pse nuk janë mbajtur të dhëna të tilla, Gjykata nuk sheh asnjë shenjë se marrjet joformale në pyetje të prokurorit me dëshmitarët kishin ndonjë influencë në dëshmitë e tyre, në dëm të pandehurit.

Vërejtje të përgjithshme në lidhje me besueshmërinë e dëshmive të dëshmitarëve para Trupit Gjykues

72. Të gjithë Dëshmitarët e dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor tashmë janë dëgjuar gjatë fazës së Procedurës Paraprake ose nga Policia duke përfshirë edhe Njësinë e EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL), ose nga Prokurori. Përveç kësaj, shumica e tyre janë dëgjuar më parë gjatë gjykimit të G., ku trupi gjykues ka arritur në përfundimin se dëshmitë e tyre ishin - me disa përjashtime - të besueshme²². Deklaratat e tyre të dhëna gjatë gjykimit të G. ishin përgjithësisht në përputhje me ato të dhëna në fazën e procedurës paraprake.

73. Megjithatë, gjatë këtij gjykimi trupi gjykues vërejtë se të njëjtët dëshmitarë duket të kenë zbutur përshkrimet e tyre të mizorive që ata më parë kishin deklaruar se i kishin pësuar dhe / ose rolin e luajtur të të pandehurit aty. Asnjë shpjegim i kënaqshëm nuk është dhënë lidhur me këto divergjenca e as Trupi Gjykues nuk ka gjetur ndonjë tregues konkret të presionit ndaj dëshmitarëve nga ana e Prokurorisë gjatë deklaratave të tyre të mëparshme apo nga mbrojtësit para ose gjatë shqyrtimit gjyqësor.

74. Është një fakt i njohur që me kalimin e kohës edhe kujtimet më të dhimbshme, kur nuk rifreskohen rregullisht, kanë tendencë të zbehen. Pra, në përgjithësi Gjykata gjeti dëshmitë e dëshmitarëve si të besueshme ku ata i kanë konfirmuar deklaratat e tyre të dhëna më herët dhe më pak të besueshme, ku tani, shtatëmbëdhjetë vjet pas fakteve dhe më shumë se pesë vjet pas deklaratave të tyre të fundit, ato ndryshonin prej atyre.

Besueshmëria e Dëshmitarit H dhe Dëshmitarit I. I.

²² Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, aktgjykimi, S. G. e të tj. (rasti nr. P 45/2010), 29 korrik 2011, par. 50

75. Të dy, Dëshmitari H dhe Dëshmitari I. I. kanë dhënë dëshmi të hollësishme në të cilat ata kanë konfirmuar deklaratat e tyre të mëparshme. Edhe nëse ka pasur kontradikta ato kanë të vogla. Prandaj, Trupi Gjykyes kryesisht do të mbështetet në këto dy dëshmi dhe do të konstatojë si dëshmi mbështetëse dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të cilët ose ishin dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor ose deklaratat e mëhershme të cilëve ishin konsideruar si të lexuara me marrëveshje të palëve.

V.6 Analiza e provave; faktet e përcaktuara për pika të aktakuzës

PIKA I, Krimi i luftës kundër popullatës civile

Pozita e lartë graduere e të pandehurit

76. Gjykata, në bazë të dëshmive të dëgjuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk e ka gjetur si të vërtetuar se i pandehuri ka mbajtur një pozitë të lartë në Qendrën e UÇK-së në K. (Shqipëri).

77. Sipas Dëshmitarit A. I., i pandehuri **Xh. K.** ka ndihmuar me logjistikë në Brigadën e UÇK-së 125²³. Dëshmitari Ru. S. ka dëshmuar se i pandehuri ishte një furnizues i Brigadës 125²⁴. Edhe pse kjo nuk e përjashton që i pandehuri ka mbajtur në të njëjtën kohë edhe një pozitë të lartë graduere në kampin e K., dhe nga dëshmitë e Dëshmitarit F dhe Dëshmitarit K, siç do të diskutohet më poshtë nën §§ 147-150, me të vërtetë mund të konkludohet se i pandehuri kishte një ndikim të caktuar në kushtet në të cilat të burgosurit ishin mbajtur, asnjë nga Dëshmitarët nuk e ka përshkruar të pandehurin si njërin, ose në mesin e atyre që kanë qenë në komandën e objekteve të K..

PIKA 1, vrasje

78. Disa dëshmitarë kanë dhënë deklaratat në lidhje me vdekjen e A. B.. Megjithatë, emri i **Xh. K.** si kryerës i mundshëm mund të gjendet vetëm në procesverbalet e deklaratave të dhëna nga Dëshmitari B para këtij gjykimi.

79. I përballur me këto deklaratat gjatë marrjes së tij në pyetje para kësaj Gjykate, Dëshmitari B ka mohuar të ketë thënë ndonjëherë se i pandehuri **Xh. K.** i ka qenë i përfshirë në vrasjen e

²³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 30 maj 2016, f. 14 prej 43

²⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 7 korrik 2016, p. 17 prej 43

A. B.. Në të kundërtën, Dëshmitari B ka deklaruar se ai kurrë nuk e kishte parë të pandehurin në kampin e K.²⁵.

80. Prokurori argumentoi se dëshmia e Dëshmitarit B gjatë shqyrtimit gjyqësor është në kundërshtim flagrant me deklaratat e tij të mëparshme dhe, për këtë arsye, është e pabesueshme.

81. Trupi Gjykues nuk do të vlerësojë çështjen e besueshmërisë së deklaratave të ndryshme të dhëna nga Dëshmitari B, pasi që është i detyruar me faktin se as deklaratat e mëparshme të Dëshmitarit B e as dëshmitë e tij në gjykim, siç është shtjelluar më lart në § 64, mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë. Duke lënë mënjanë deklaratat e Dëshmitarit B, trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë provë që e lidh penalisht të pandehurin **Xh. K.** me vrasjen e A. B..

Ndërmarrja e përbashkët kriminale (NPK)

82. Prokurori, në fjalën përfundimtare, ka propozuar për të mbajtur të pandehurin penalisht përgjegjës për vrasjen e A. B. në bazë të konceptit të Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale (NPK), dhe më saktësisht variantin e zgjeruar.

83. Ndërsa neni 22 i KP i RSFJ-së përcakton bashkëkryerjen si disa persona që kryejnë së bashku një vepër penale "duke marrë pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër", TNPJ në jurisprudencën e saj ka miratuar teorinë e bashkëkryerjes, bazuar në projektin e përbashkët kriminal²⁶.

84. Teoria e bashkëkryerjes bazuar në NPK zbeh rëndësinë e kontributit të të akuzuarit për planin e përbashkët kriminal dhe, në vend të kësaj, përqendrohet në qëllimin e tij si kriter përcaktues për përgjegjësinë e tij si një bashkë-kryerës: d.m.th. nëse i akuzuari ndan qëllimin për të kryer krimin e përbashkët dhe kështu identifikon veten me qëllimin e përbashkët kriminal, ai

²⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 11 prill 2016, f.28 prej 56

²⁶ TNPJ Dhoma e Apelit, Tadic (IT-94-1), Aktgjykimi, 15 korrik 1999, par. 185-229; TNPJ Dhoma e Apelit, (IT-00-39), Aktgjykimi, 17 mars 1999, par. 185-229

është përgjegjës si një bashkë-kryerës në NPK, edhe në qoftë se kontributi i tij ishte më pak se i domosdoshëm, edhe pse sidoqoftë ai duhet të jetë së paku një kontribut i rëndësishëm.

85. TNPJ ka identifikuar tri variante të NPK-së, të quajtura kategori 'bazike', 'sistematike' dhe 'të zgjeruara' të NPK-së, të cilat kanë të njëjtat elemente objektive: (i) një shumicë të individëve; (ii) një plan të përbashkët që kanë për qëllim ose që përfshin një krim dhe (iii) kontributin e rëndësishëm të të akuzuarit për planin në fjalë. Dallimi në mes të tri kategorive të NPK-së qëndron në elementet e tyre subjektive.
86. Tipi 'bazik' i NPK-së kërkon që i akuzuari të ndan qëllimin e përbashkët për të kryer krimin e grupit. Kategoria "sistematike" e NPK-së, e cila zbatohet në rastet që kanë të bëjnë me sistemet e keqtrajtimit (p.sh. kampet e përqendrimit), kërkon që i akuzuari të ketë njohuri për natyrën e këtij sistemi dhe ka për qëllim që të shtyj më tej qëllimin e tij kriminal. Së fundi, forma e "zgjeruar" e NPK lejon ngarkimin e përgjegjësisë për një krim që është kryer jashtë fushëveprimit origjinal (NPK 'bazike/sistematike') të planit të përbashkët, nëse: (i) ka qenë e parashikueshme që një krim i tillë mund të kryhet nga një apo anëtarë tjerë të grupit dhe (ii) i akuzuari me dashje e ndërmori atë rrezik".²⁷ Prania e pjesëmarrësit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale në kohën kur krimi është kryer nga shkelësi kryesor nuk është e nevojshme.²⁸
87. Ekzistojnë argumente në favor të zbatimit të drejtpërdrejtë të konceptit të NPK-së në të gjitha variantet e saj në rastet e krimeve të luftës të kryera gjatë luftës në Kosovë. Megjithatë, aktakuza në këtë rast, është kryesisht e bazuar në ligjin e brendshëm. Dhe edhe pse jurisprudenca e Tribunalit të Hagës mund të jetë e dobishme në interpretimin e bashkëkryerjes sipas nenit 22 të KP i RSFJ-së, ajo nuk mund të vazhdojë zbatimin e saj përtej kufijve ligjorë të dhënë nga ky nen, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 2 të KPRK-së.

²⁷ Lachezar Yanev, ' *Co-Perpetration responsibility in the Kosovo Specialist Chambers Staying on the Beaten Path?* (*përkthim i përkthyesit* 'Përgjegjësia e bashkë-kryerjes në Dhomat e Specializuara të Kosovës në rrugën e shkelur?', *Journal of International Criminal Justice* 14 (2016), 107-108, me referenca tjera

²⁸ TNPJ Dhoma e Gjykimimit, Limaj e të tj. (IT-03-66-T), Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, par. 511

88. Duke përfshirë NPK-në në variantin e saj e vazhduar në interpretimin e nenit 22 të KP i RSFJ-së, siç është propozuar nga prokurori, kjo do të lejonte gjetjen e bashkëkryerjes së të pandehurit në një vrasje në të cilën ai nuk ka qenë i pranishëm të vërtetuar në bazën e vetme të qëllimit të tij përfundimtar (*dolus eventualis*). Sipas mendimit të trupit gjykues, një interpretim i tillë do të shtrinte kuptimin e bashkëkryerjes përtej kufijve të përcaktuar në nenin 22 të KP i RSFJ-së, dhe shkel parimin e ligjshmërisë.

Përfundim

89. Gjykata, pra, nuk e ka gjetur si të vërtetuar se i pandehuri, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me anëtarë të tjerë të UÇK-së, ka vrarë A. B. gjersa ai ka qenë i arrestuar ilegalisht në Kampin e K. duke e rrahur dhe shtënë në të.

PIKA 2, paraburgimi i paligjshëm

90. Dëshmitari C nuk u dëgjua gjatë shqyrtimit gjyqësor, por me pëlqimin e të dyja palëve, deklaratat e saj të mëparshme ishin konsideruar si të lexuara.²⁹

Dëshmitarja C rrëfen se ajo ishte në shtëpinë e An. dhe Dëshmitari B, i dashuri i C-së, kur erdhi një veturë me njerëz që flisnin serbisht. Ata u dërguan në kufirin shqiptar. Kur kanë shkuar në K., erdhi një Jeep me dy anëtarë të UÇK-së në uniformë të zezë. Ata biseduan me An. dhe pastaj u dërguan të gjithë në qendrën e UÇK-së atje, ku u vendosën menjëherë në një depo³⁰. Gjatë ditës së parë, ata u mbyllën në atë që dukej si një depo, pa dhënë asnjë justifikim apo arsye. Aty ishte një person që i ruante ata.³¹ Më vonë, ajo u dërgua në një dhomë shumë të vogël, rreth 2x2 m, pranë tualeteve.³²

91. Të dy Dëshmitari D dhe Dëshmitari E, dy vëllezër romë, muzikantë nga Pr., kanë dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor se ata ishin arrestuar dhe sjellë në K., ku janë mbajtur.

Dëshmitari D dëshmoi se ai shkoi me familjen e tij, duke përfshirë Dëshmitarin E, në K. gjatë luftës, pas bombardimeve të NATO-s. Ai u arrestua në K. nga dy persona. Ata ishin me maska dhe uniforma të UÇK-së. I çuan ata në një lloj fabrike. Njerëzit atje ishin të veshur me uniforma të UÇK-së. Ata iu thanë atyre se ishin të dyshuar për diçka. Ata

²⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 11 prill 2016, f.55 prej 56.

³⁰ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit i datës 17 dhjetor 2009, regjistratori i prokurorisë C2, f. C 291 (181)

³¹ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit i datës 17 dhjetor 2009, regjistratori i prokurorisë C2, f. C 292 (182)

³² Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit i datës 17 dhjetor 2009, regjistratori i prokurorisë C2, f. C 294 (184)

pastaj i mbajten atje për punë.³³ Në një pikë të caktuar atyre iu tha se ata ishin të lirë për të shkuar. Kështu ata u larguan.³⁴

Dëshmitari E dëshmoi se ai udhëtoi për në Shqipëri, gjatë luftës me familjen e tij, duke përfshirë Dëshmitarin D. Në Shqipëri, kur ata kaluan kufirin, UÇK, e veshur me uniforma dhe me maska, dyshoi në ta dhe i mori. Ata e arrestuan atë, së bashku me Dëshmitarin D, se gjoja kishin qenë policë serbë. Ata u dërguan në Shtabin e UÇK-së, në kazernat ushtarake, ku ishin mbajtur për më shumë se dy javë, ose tri javë. Ky ishte një shtab i madh.³⁵ Ka qenë edhe një rom i tretë me ta.³⁶

92. Dëshmitari F, i cili ishte një rojtar pylli para luftës, e ka emëruar të pandehurin **Xh. K.** në dëshminë e tij si person i cili ka qenë i përfshirë direkt në arrestimin e tij dhe mbajtjen e paligjshme. Dëshmitari F e dinte emrin e të pandehurit, pasi që fshatrat e tyre ishin aty pranë dhe ai, për këtë arsye, njihej me të. Për më tepër, ai e njohu të pandehurin gjatë shqyrtimit kryesor të datës 18 prill 2016, nga fotografia nr. 47 (regjistratori C2, faqe 376 (C441-16))³⁷.

Dëshmitari F dëshmoi se ai u largua nga Kosova më 28 prill 1999 dhe shkoi me familjen e tij në K.. Dy javë pasi arritën atje, rreth mesit të muajit maj 1999, dy persona erdhën dhe e ftuan atë që t'i ndjekë në mënyrë që të japë një deklaratë. Njëri prej tyre ishte **Xh. K.** Ata nuk ishin të veshur me uniforma. Pastaj ata shkuan me veturë në një kamp, një lloj fabrike me disa zyra. Në ndërkohë, ky dëgjoi se ky ishte Shtabi i UÇK-së. E çuan në një zyrë. Dikush mori deklaratën e tij dhe pastaj e dërguan në një dhomë. Atje kanë qenë gjashtë deri në shtatë persona duke përfshirë Dëshmitarët D dhe E, të cilët ishin muzikantë romë nga Pr., dhe dy vëllezër katolik (Gjykata e kupton: Dëshmitari B dhe A. B.), të cilët u sollën aty dhjetë ditë pas mbërritjes së tij. Dhomë ku ata kishin qëndruar ishte e mbyllur. Ata qëndruan aty rreth një muaj.³⁸ Në ditën e fundit, Dëshmitari F u intervistua nga O. K. dhe pastaj u lirua.³⁹

93. Dëshmitari H gjithashtu përmendi të pandehurin **Xh. K.** si person që ka kryer arrestimin e tij. Ai e njohu të pandehurin, për shkak se ai e kishte parë atë më parë⁴⁰.

Dëshmitari H dëshmoi se ai u largua nga Kosova për në Shqipëri më 1 prill 1999⁴¹. Ai u vendos në D.. Djali i tij, Dëshmitari I, ishte me të. Kur ishin atje, në një moment të caktuar, gjersa ai ishte i vetëm me djalin e tij, **Xh. K.** erdhi së bashku me një person

³³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 13 prill 2016, f.8-11 prej 51

³⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 13 prill 2016, f. 28 prej 51

³⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 13 prill 2016, f.34-37 prej 51

³⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 13 prill 2016, f. 39 prej 51

³⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 13 prill 2016, f. 30 prej 51

³⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 18 prill 2016, f.5-10 prej 51

³⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 18 prill 2016, f.28-29 prej 51

⁴⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 25 prill 2016, f.8 prej 55

⁴¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 25 prill 2016, f.8 prej 55

tjetër, i cili ishte një ushtarak. Ata ishin në rroba civile. **Xh.** u ndal pranë derës dhe kishte një revolver në xhepin e djathtë të xhakëtës së tij. Personi tjetër hyri në oborr. Ata u interesuan për një familje të caktuar nga J.. Pastaj të dy u larguan.⁴² Në një rast tjetër, kur ai ishte në rrugë, erdhi një veturë pa targa. Shoferi, i cili ishte i vetëm, pyeti në lidhje me një familje të caktuar, dhe pastaj i tha atij që të hyjë në veturë, të cilën Dëshmitari H e refuzoi. Shoferi tha se ai ishte nga Policia e UÇK-së. Ai ia vuri një armë në lartësinë e shpatullave e tij dhe e bëri gati. Ai arriti që t'ia marrë armën nga duart dhe e vendosi në tokë. Kur familja e tij doli nga shtëpia, ai u ngrit dhe u largua.⁴³ Më 18 maj 1999, ai ishte kërcënuar sërish me armë dhe ishte marrë nga katër persona. Ata e dërguan pastaj në "R.", ku e futën në një bunker. Më pas, më 21 maj 1999, e kapën atë dhe tre persona të tjerë në K..⁴⁴ Në K. i çuan në një ndërtesë të braktisur. Ata pastaj e dërguan atë në një dhomë në katin e parë. Nën shkallë ishte një burg i improvizuar. Kur ai hyri, aty tashmë ishte një person tjetër: Dëshmitari A. Më 22 maj 1999, ata e sollën në dhomë A. B. dhe Dëshmitarin B. Gjithashtu, atje kanë qenë tre romë, muzikantë nga një fshat aty pranë Pr. (Gjykata e kupton: Dëshmitari D dhe E dhe romi i tretë), dhe një rojtar pylli (Gjykata e kupton: Dëshmitari F). Ai gjithashtu e mban mend një administrator shkollë nga I. Dy ditë më vonë, ai, së bashku me Dëshmitarët A, B dhe A. B. u zhvendosën në një dhomë të depos ku mbaheshin pjesë këmbimi të traktorëve. Ata e gjetën aty romin dhe drejtorin e shkollës dhe dy ose tri ditë më vonë ata e sollën rojën e pyllit. Dhomë ishte e mbyllur nga jashtë, dhe dy roje të armatosura me uniforma të UÇK-së po qëndronin tek dera⁴⁵. Dëshmitari H ka qëndruar në K. nga data 21 maj deri më 1 qershor 1999, kur ai u lirua.

94. Në përgjithësi Dëshmitari I e ka konfirmuar dëshminë e Dëshmitarit H.

Dëshmitari I dëshmoi se më 1 prill të vitit 1999, ai ishte larguar nga Kosova për të shkuar në Shqipëri me tërë familjen e tij, përfshirë dëshmitarin H, babanë e tij. Ata ishin nisur nga Pr. dhe kishin shkuar me tërë konvojin që ishte nisur për në D., ku kanë qëndruar te halla/tezja. Në tre raste kishin ardhur njerëz në banesë për të kërkuar babanë e tij. Herën e parë kishte ardhur një veturë, shoferi kishte ndaluar automjetin ku qëndronte babai i tij dhe kishte folur me të, për të pyetur për një familje të caktuar, siç i kishte treguar më vonë babai. Shoferi pastaj kishte nxjerr një armë dhe i kishte thënë babait të tij të futej brenda. Kishte filluar një përleshje. Ai doli jashtë me kushëririn e tij, ata ndaluan përleshjen dhe personi u largua tutje me veturën e tij. Herën e dytë, ai ishte në shtëpi me babanë e tij, para shtëpisë. Personi i njëjtë kishte ardhur së bashku me **Xh. K.** Të dy ishin të armatosur. Ata nuk ishin të veshur në uniformë. Ata anash mbanin armët. **Xh. K.** priste te porta, ndërsa personi tjetër ishte futur në oborr. Pastaj ata vozitën tutje. Herën e tretë, ishin dy policë nga Shqipëria dhe shtatë ose tetë burra të tjerë, në mesin e të cilëve **Xh. K.** **Xh. K.** mbante një armë. Ata deshën të futeshin brenda në shtëpi dhe të merrnin Dëshmitarin H. Pronari i tha policëve shqiptarë ose të tregonin urdhrin e gjykatës për bastisjen e shtëpisë ose të largoheshin nga objekti, ndryshe ai do të shkonte në stacionin policor. Atëherë ata dolën jashtë dhe të nesërmen ai dhe familja u vendosën

⁴² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 25 prill 2016, f.8 prej 55

⁴³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 25 prill 2016, f.6 prej 55

⁴⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 25 prill 2016, f.8 prej 55

⁴⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 25 prill 2016, f.30 prej 55

në një banesë tjetër. Në ditën që Dëshmitari H ishte kidnapuar ishte data 17 ose 18 maj 1999. Atë ditë ai, babai i tij dhe pronari kishin dal për një shëtitje. Në një pikë të caktuar, një veturë ndaloi dhe katër persona që mbanin pistoleta në duar dolën jashtë. Ata i drejtuan armët në drejtim të tyre. Ata u përleshën me ta por u mposhtën dhe ata e futën Dëshmitarin H në veturë me dhunë. Pastaj ata u larguan në një drejtim të panjohur.⁴⁶

95. Dëshmitari K dëshmoi se ai ishte arrestuar dhe më vonë ishte mbajtur në K., ku ka përmendur të pandehurin **Xh. K.** si njërin nga personat të cilët e kishin arrestuar dhe e kishin dërguar atë nga kampi në C. në K.. Dikush i kishte thënë atij se ishte **Xh. K.**, emrin e të cilit ai e dinte edhe më herët.⁴⁷

Dëshmitari K dëshmoi se më 28 mars 1999, ai ishte larguar nga Kosova për të shkuar në D.. Pas 10 ose 12 ditëve, ai ishte arrestuar atje. Ai kishte dal nga kampi i punëtorëve ku qëndronte dhe një veturë ishte ndaluar. Dy personat në veturë e pyetën për emrin. Pastaj njëri nga ata doli jashtë dhe i tha të shkonte me ta sepse ata kishin disa pyetje për të. Ata i treguan atij një letër dhe i thanë se ata ishin nga UÇK-ja. Ai u fut në veturë me ta. Ata e dërguan atë në Shtabin e UÇK-së në D., një hotel i quajtur D.. Në hotel, **Xh. K.** u fut i pari brenda. Pastaj ata e dërguan atë në një dhomë para një personi i cili i tha se ai ishte gjyqtar ose prokuror nga Tirana dhe i bëri atij disa pyetje bazike. Pas një kohe, **Xh. K.** tha se nuk ishte nevoja për pyetje të tjera. Pas marrjes në pyetje, ata e dërguan atë në një dhomë tjetër, ku ai qëndroi dy ditë dhe një natë. Ai pastaj ishte dërguar në një lokacion tjetër afër bregdetit nga dy pjesëtar në uniformë të UÇK-së. Pastaj, dikush kishte intervenuar dhe ata e kishin kthyer atë në Hotel D.. Pas pak, ai ishte vendosur në një furgon me ushtarët dhe ata u nisën në drejtim të K..⁴⁸ Pas tre ditësh, dikush erdhi dhe e dërgoi atë në C., K.. **Xh. K.** kishte ardhur dy ose tre herë në C., dhe herën e tretë, ai e mori atë me vete dhe e dërgoi atë në K.. **Xh.** erdhi me veturë së bashku me një shok, për të cilin ai beson se ishte A. Ha..⁴⁹ Në K., **Xh.** e dërgoi atë në një dhomë me një roje te dera. Dera nuk ishte e mbyllur me çelës por kishte roje të cilët kishin armë. Ai kishte parë romë në K.. Ata ishin muzikantë nga Pr.. Në ditën e lirim të tij, **Xh. K.** erdhi dhe i tha se përveç nëse do ta vrisnin atë, ndryshe ai (**K.**) do ta lironte atë. Të njëjtën pasditë, ai ishte liruar.⁵⁰

96. Në dëshmitë e cituara më lartë, A. B., Dëshmitarët B, A, D dhe E përmenden si të ndaluarit e tjerë. Të dy Dëshmitarët D dhe E i kanë quajtur objektet 'Shtabi i UÇK-së', ndërsa të tjerët i kanë përshkruar objektet se përfshinin një depo dhe dhoma të ndryshme ku mbaheshin të ndaluarit.

⁴⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 13 maj 2016, f. 6-12 nga 21

⁴⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 7-8 nga 41

⁴⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 5-12 nga 41

⁴⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 18-19 nga 41

⁵⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 22-30 nga 41

97. Mbi bazën e këtyre dëshmimeve, Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri **Xh. K.**, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S. G. dhe pjesëtarë e tjerë të UÇK-së, kanë arrestuar dhe kanë ndaluar në mënyrë të paligjshme Dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H, K, A. B. dhe civilët e tjerë të panjohur në një qendër të UÇK-së për një periudhë të zgjatur kohore në K. (në veri të Shqipërisë) gjatë muajve prill, maj dhe deri në gjysmën e muajit qershor të vitit 1999. Prova lidhur me rolin e S. G. si bashkëkryerës do të vlerësohet më poshtë në §§ 121-125.

PIKA 3, kushte çnjerëzore

98. Dëshmitari C, Dëshmitari E, Dëshmitari F dhe Dëshmitari H, në deklaratat e tyre kanë përshkruar kushtet në të cilat janë mbajtur në qendrën e UÇK-së në K..

99. Siç u përmend më lartë, Dëshmitarja C nuk ishte dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, por me marrëveshje në mes të dyja palëve, deklaratat e saj të mëparshme ishin konsideruar si të lexuara. Deklaratat e saj përmbajnë si në vijim.

Ajo ishte dërguar në një dhomë shumë të vogël, rreth 2x2 metra, afër tualeteve. Ishte në të njëjtin oborr, në një ndërtesë të gjatë dhe aty pjesëtarët e UÇK-së e kishin zyrën ku merrnin personat në pyetje. Në dhomën e saj nuk kishte orendi, vetëm baltë dhe rërë, dhe një dyshek shumë i hollë.⁵¹

100. Dëshmitari E dëshmoi si në vijim.

Ata kishin fjetur në dyshekë në depon ku ruhej ushqimi. Dy apo tre ditët e para ata qëndruan në një dhomë të vogël prej afro 4x3 metra. Atje ata ishin diku katër apo pesë: vetëm punëtorët.⁵²

101. Dëshmitari F e përshkruajti dhomën në të cilën ishin mbajtur si në vijim.

Ishte një dhomë prej afërsisht 6x6 ose 6x8 metra. Për tre apo katër ditë ata kishin fjetur në një dysheme të betonit. Pastaj, atyre u kishin sjell batanije dhe dyshekë nga sfungjeri. Batanijet më vonë ishin marrë. Një ditë **Xh. K.** kishte ardhur te dera dhe kishte bërë një bisedë me të për batanijet, dhe disa orë më vonë dikush i kishte sjell ato sërish. **Xh. K.** gjithashtu kishte pyetur për lëndimet e tij. Çdo të dytën ditë arrinte një rezervar me ujë të freskët. Atyre i jepej ushqim në konserva dhe gjithashtu bukë. Dëshmitarit F iu kujtua se atij i lejohej të lahej një herë.⁵³ Një ditë, gjatë ditës,

⁵¹ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit i datës 17 dhjetor 2009, Regjistratori i Prokurorisë C2, f. C 294 (184)

⁵² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 13 prill 2016, f. 41 nga 51

⁵³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 18 prill 2016, f. 8-9 nga 51

Dëshmitari F kishte dëgjuar të shtëna dhe më vonë kishte parë se vëllai më i madh katolik kishte një lëndim në gju. Dëshmitari F kishte parë fashën dhe kishte gjak. Vëllai i vogël gjithashtu kishte një plagë nga arma në shputën e tij. Në mëngjes, kur ishin zgjuar, aty ishte një doktor. Pas një ore, vëllai më i madh Katolik ishte nxjerrë nga dhoma në batanije. Më vonë ai kishte mësuar se ai kishte vdekur.⁵⁴

102. Dëshmitari H ka përshkruar burgun e improvizuar në të cilin ai ishte mbajtur pas mbërritjes së tij në kampin në K..

Ata e kishin dërguar atë në një dhomë në katin e parë. Nën shkallë ishte një burg i improvizuar, një dhomë shumë e vogël, lartësia dhe gjerësia e së cilës ishte e njëjtë me atë të shkallëve. Aty nuk kishte orendi. Kur ai kishte hyrë aty, aty ishte edhe një person tjetër: Dëshmitari A. Aty nuk kishte dritë.⁵⁵ Pas dy ditësh, ata e dërguan atë, A, B dhe An. në një dhomë të depos ku mbaheshin pjesë rezervë të traktorëve. Aty i gjetën romët dhe drejtorin e shkollës, dhe pas dy ose tre ditëve aty e sollën edhe rojën e pyllit. Dhoma ishte 3 x 4,5 metra. Dyshemeja ishte nga betoni. Dy apo tre nga ta kishin batanije dhe gjithashtu dyshekë, 1 cm të trashë.⁵⁶ Ata më shumë ishin të uritur se sa të ngopur. Ai kishte humbur mbi 16 kilogram për 10 ditë. Qasje në ujë të pastër nuk kishte dhe ata pinin ujin nga një cisternë. Ata nuk kishin mundësi të laheshin dhe mbanin erë si kafshët. Ata në tualet shoqëroheshin nga rojet.⁵⁷

103. Mbi bazën e këtyre deklaratave, Gjykata vërtetoi se i pandehuri, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S. G. dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së, kanë mbajtur dëshmitarët A, B, C, D, E, F, H, A. B. dhe civilët e tjerë të panjohur, të ndaluar në një qendër të UÇK-së nën kushte çnjerëzore (qeli të vogël, me mungesë uji, ushqimi, higjiene, ajri dhe qasje në trajtim mjekësor) në K. (në veri të Shqipërisë) gjatë muajve prill, maj dhe deri në gjysmën e muajit qershor të vitit 1999. Prova mbi rolin e S. G. si bashkëkryerës do të diskutohet më poshtë në §§ 121-125.

104. Trupi gjykues e gjeti si të vërtetuar se kishte mungesë të qasjes në trajtim mjekësor bazuar në faktit se, sipas dëshmisë së Dëshmitarit F, vetëm në mëngjesin pasi të dy vëllezërit katolik ishin qëlluar nga predhat e armëve, doktori ishte i pranishëm, dhe se vëllai i madh katolik (Gjykata e ka fjalën për: A. B.) kishte vdekur jo shumë kohë më pas.

105. Gjykata do të sqaroj në vijim në §§ 138-150 se përse e ka kualifikuar përfshirjen e të pandehurit **Xh. K.** si bashkëkryerje.

⁵⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 18 prill 2016, f. 25-28 nga 51

⁵⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 17 nga 55

⁵⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 30 nga 55

⁵⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 31 nga 55

PIKA 4, tortura

106. Në jurisprudencën e TNPJ-së, tortura përkufizohet si shkaktim i “dhembjes apo vuajtjes së rëndë fizike apo mendore me qëllim të marrjes së informacionit apo pranimit të fajit, apo me qëllim dënimi, frikësimi apo shtrëngimi apo për çfarëdo arsye bazuar në diskriminimin e ndonjë forme”.⁵⁸
107. Në deklaratat e tyre Dëshmitarja C dhe Dëshmitari H kanë përshkruar se si ishin keqtrajtuar në kampin e K..
108. Dëshmitarja C përshkruajti jo vetëm keqtrajtimin e saj por edhe keqtrajtimin e Dëshmitarit B dhe A. B..

Dëshmitarja C theksoi se pas tre ditësh nga mbërritja e saj në K., ajo dëgjoi një zhurmë të rrahjes. Tre persona ishin zgjuar nga gjumi për të shikuar se si rrihej An., me shkopinj të drurit dhe me një shkop gome. Ata po e pyesnin atë se si kishte shkuar ai atje dhe kur ai përgjigjej se serbët e kishin dërguar atje, ata po e rrihnin atë duke e quajtur tradhtar. Ata gjithashtu e dërguan Dëshmitarin B atje për të parë se çfarë i bënin ata An.. Ata e rrahën Dëshmitarin B, edhe pse ata e rrahën A. B. më shumë se Dëshmitarin B. Ata gjithashtu e rrahën atë, duke e goditur me shuplakë në fytyrë dhe duke e shkelmuar, dhe duke e pyetur se përse ajo ishte me ta.⁵⁹ Dy ushtarë e morën atë, gjersa gjashtë apo shtatë të tjerë e rrihnin An.. Të dy ushtarët e goditën me shuplaka dhe e shqelmuar atë. Kjo zgjati nga gjysmë ore deri në një orë. Pastaj ata filluan ta rrihnin atë me shkopinj të fortë të plastikës derisa ajo humbi ndjenjat. Ata vazhduan ta pyesnin atë nëse An. dhe Dëshmitari B ishin spiunë serb. Kur ajo u zgjua, ata filluan ta rrihnin atë përsëri.⁶⁰ Atë natë ata i ndanë dhe ajo kurrë më nuk e kishte parë A. B..⁶¹

109. Në dëshminë e tij, dëshmitari H, përveç torturimit që kishte përjetuar vetë, gjithashtu përmendi torturimin e Dëshmitarit A, Dëshmitarit B dhe An..

Dëshmitari H dëshmoi se pas datës 22 [të muajit maj të vitit 1999], ata e dërguan atë në një zyrë ku në derë të saj ishte mbishkrimi ‘juristët’. Në shkallët poshtë, personat e njëjtë të cilët e kishin sjell, filluan ta grushtonin atë. Në këtë zyrë me mbishkrimin ‘juristët’, ai pa **Xh. K.** dhe shumë persona të tjerë, në mesin e të cilëve S. G., P. Sh., M. Z., Xh. I. dhe A. Ç.. Kjo ishte hera e parë që ai e kishte parë **Xh. K.** në K..

⁵⁸ Shih, në mes tjerash, Aktgjykimin e TNPJ-së, *Anto Furundzija* (IT-95-17), Gjykimi, 10 dhjetor 1998, Par. 159-160, me referencat vijuese.

⁵⁹ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit i datës 17 dhjetor 2009, Regjistratori i Prokurorisë C2, f. C292-C293 (182-183)

⁶⁰ Raport i deklaratës nga marrja në pyetje e datës 9 prill 2009, Regjistratori i Prokurorisë C2, f. C324 (214)

⁶¹ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit i datës 17 dhjetor 2009, Regjistratori i Prokurorisë C2, f. C292-C293 (183)

Xh.K. mbante një shkop gome në dorë dhe i tha atij se ata po e prisnin. Pastaj **Xh. K.** filloi ta rrihte atë me shkop gome të cilin ai e mbante në dorën e tij të djathtë, ndërsa me dorën e majtë ai e goditi me shuplakë në gojë. Dhe ai tha: “ti ke vrarë 100 njerëz dhe dhunuar 50 gra”. **Xh. K.** e fiku cigaren e vet në gjoksin e tij dhe pastaj e goditi atë me armë në kokë, si rezultat i së cilës ai mori lëndime. Pastaj **Xh.** ia theu bërrylin me shkopin e gomës. Si rezultat, ai nuk mund ta drejtoj atë më. **Xh. K.** gjithashtu futi shkopin e gomës në gojën e tij dhe theu urën e dhëmbëve. Shokët e **Xh., S. G., P. Sh.** dhe të tjerët të cilët ai nuk mund t’i shihte, sepse ishin prapa tij, gjithashtu e kishin goditur atë natë. Rrahja vazhdoi për afërsisht 30 minuta. Kur **Xh. K.** e goditi atë me dorezën e revoles së tij, ai humbi ndjenjat dhe ra për tokë. Pastaj **Xh. K.** mori një kovë me ujë dhe e derdhi mbi të. Ai u zgjua, por përsëri humbi ndjenjat sepse ai kishte marrë një goditje të rëndë, si pasojë e së cilës humbi shikimin. Të gjithë të burgosurit ishin rrahur atë natë, përveç rojës së pyllit, i cili nuk ishte aty atë moment. Ata sollën një femër (Gjykata e kupton: Dëshmitaren C). Ata e detyruan atë të thotë se në shtëpinë e të dy vëllezërve (Gjykata e kupton: A. B. dhe dëshmitarin B) kishin ardhur vetëm serb. Ai e pa Dëshmitarin A të keqtrajtohej atë natë nga S. G.. Ai e pa dëshmitarin A përsëri më vonë atë natë, dhe ai ishte në gjendje jashtëzakonisht të keqe. Këmbët dhe duart e tij ishin ënjtur, ai kishte mavijosje në trupin e tij të cilat dëshmitari A ia tregoi të gjitha.⁶² Personat e njëjtë të cilët e kishin rrahur atë (Dëshmitarin H) filluan ta rrihnin Dëshmitarin B dhe A. B.. **Xh. K.** ishte më agresivi prej tyre. Kur ata u kthyen përsëri në dhomë, ishin në gjendje aq të keqe saqë nuk mund as të qëndronin dhe as të shtriheshin. Ata ishin rrahur shumë keq në këmbët dhe në duart e tyre dhe vëllait i cili ende është gjallë (Gjykata e kupton: Dëshmitari B) i ishte thyer klavikula.⁶³

110. Dëshmitari I vërtetoi dëshminë e Dëshmitarit H.

Dëshmitari I dëshmoi se Dëshmitari H ishte zhdukur për 13 ditë deri atëherë kur ishte kthyer në banesën në D. ku ata qëndronin. Gjendja e tij ishte shumë katastrofike. Ai kishte plagë të djegies nga cigarja, lëndime trupore, dhe balli i tij ishte i lënduar, dhëmbët i kishte të thyer dhe gjendja e tij shëndetësore ishte shumë e keqe. Dëshmitari H i tha atij se **Xh. K.** dhe personat e tjerë të cilët i njeh **K.**, kishin bërë të gjitha këto tortura çnjerëzore.⁶⁴

111. Nga deklaratat e Dëshmitares C, duket qartë se ata i ishin nënshtruar dhimbjes së rëndë fizike dhe psikike me qëllim të nxjerrjes së informacionit apo pranimit të fajit. Prandaj, keqtrajtimet e përshkruara nga dëshmitarët, i përgjigjen përkufizimit të torturës siç përmendet më lartë.

112. Mbi bazën e deklaratave të Dëshmitares C dhe Dëshmitarit H, Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri **Xh. K.**, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S. G. dhe

⁶² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 18-28 nga 55

⁶³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 28-30 nga 55

⁶⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 13 maj 2016, f. 12 deri 21

pjesëtarët e tjerë të UÇK-së, kanë torturuar Dëshmitarët A, B, C, H dhe A. B. duke i rrahur ata deri në humbjen e ndjenjave me shkopinj gome dhe druri, në K. (në veri të Shqipërisë) në një ditë të pacaktuar gjatë majit të vitit 1999. Roli i S. G. në këtë torturë përmendet shprehimisht nga Dëshmitari H.

113. Gjykata nuk mundi të vërtetoj se i pandehuri ishte i pranishëm ose ndryshe i përfshirë në torturën e dytë, incidenti i përmendur në kuadër të kësaj pike, pasi që, siç u diskutua më lartë nën Pikën 1, emri i **Xh. K.** lidhur me këtë incident mund të gjendet vetëm në procesverbalet dhe deklaratat e Dëshmitarit B të dhëna para këtij gjykimi, dhe kur ishte ballafaquar me këto deklarata gjatë marrjes së tij në pyetje para kësaj gjykate, Dëshmitari B ka mohuar të ketë thënë ndonjëherë se i pandehuri **Xh. K.** kishte qenë i përfshirë.

114. Prandaj, Gjykata gjeti se nuk është vërtetuar se i pandehuri në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S. G. dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së, kanë torturuar Dëshmitarin B dhe A. B. duke i urdhëruar ata të veshin jelekë anti-plumb dhe pastaj duke qëlluar ata dhe duke i urdhëruar të tjerët të qëllonin në ta me armë automatike, në K. (në veri të Shqipërisë) në një datë të pacaktuar në qershor të vitit 1999.

PIKA 5, shkelje e integritetit trupor apo shëndetit

115. Dëshmitarja C në deklaratën e saj dhe Dëshmitari F në dëshmitë e tyre kanë folur për rrahje të vazhdueshme apo të përsëritura.

Dëshmitarja C theksoi se pas natës së rrahjes, ata e vendosën atë në një dhomë që kishte dysheme prej dheu dhe një shtrat. Ajo qëndroi aty për rreth një javë. Ata e kishin dërguar dy herë atë nga kjo dhomë në një dhomë tjetër. Në atë dhomë ishte A. B.. Ata e rrihnin atë dhe An.. Në fund, një ditë ata sollën aty një doktor për ta kontrolluar. Doktorin i tha atyre që mos ta rrihnin sepse ajo ishte në gjendje të keqe dhe se do vdiste. Pasi që doktorin e kishte kontrolluar atë, ata e rrihnin atë më pak.⁶⁵

116. Dëshmitari F i përshkruajti rrahjet si në vijim.

Derisa ai kishte qëndruar në K., ai ishte goditur një herë në mbrëmje, gjersa ishte terr, dhe dy ose tre persona ishin futur brenda dhe i kishin rrahur ata. Ata e kishin grushtuar atë në sy dhe syri ishte mbyllur. Nga hunda e tij kishte rrjedhur gjak. Edhe të tjerët që ishin në dhomë ishin rrahur. Kur ata ishin futur brenda, ata i kishin pyetur secilin nga ta se si i kishin emrat dhe se ku kishin punuar në të kaluarën, pasi që aty

⁶⁵ Raport i deklaratës së marrjes në pyetje i datës 9 prill 2009, Regjistratori i Prokurorisë C2, f. C324 (214)

ishin vendosur si bashkëpunëtor. Ai iu përgjigj atyre se ai ishte i pastër por një person kishte thënë se ai ishte spiun, tradhtar. Njëri nga të burgosurit ishte qëlluar tre apo katër herë me një shkop gome. Disa ditë më vonë, ai ishte qëlluar në shpinë me një shkop gome. Ata ishin në dhomë, me fytyrë nga muri. Të gjithë nga ta ishin rrahur atë ditë. Ka ndodhur që personat ishin marrë nga dhoma për tu marrë në pyetje. Ata të cilët merreshin nga dhoma për tu marrë në pyetje, rriheshin. Kjo kishte ndodhur disa herë.⁶⁶

117. Dëshmitari H kishte përshkruar rrahjen e tij, si dhe rrahjet e vëllezërve romë (Dëshmitarëve D dhe E), dhe të gjithë personave të tjerë të cilët ishin në qeli me të (A, B dhe An., roja e pyllit (dëshmitari F) dhe drejtori i shkollës⁶⁷). Ai gjithashtu përshkruajti se si në natën e torturës, i pandehuri **Xh. K.** kishte urdhëruar A. B. për ta rrahur atë.

Xh. K. i kishte dhënë shkopin e gomës vëllait i cili tani është i vdekur (Gjykata e kupton: A. B.), dhe, duke e shikuar Dëshmitarin H, i thotë A. B. t'ia jap 50 goditje në dorë këtij 'serbi'.⁶⁸ Ata ishin rrahur në dhomën ku flinin. Kjo ishte bërë me shkop gome nga njerëzit që ai nuk i njihnte. Ata futeshin brenda dhe i thoshin atyre të ngriheshin. Ata e kishin goditur atë 25 herë në secilën dorë. Kjo kishte ndodhur dy herë por pastaj (Gjykata e kupton: herën e dytë) erdhi një person, gjersa **Xh. K.** dhe S. D. po merrnin atë në pyetje. Rrahjet nëpër duar u kishin ndodhur të gjithë njerëzve të cilët ishin në qeli me të. Ata i merrnin në pyetje dhe i rrihnin gjatë natës. Ai ishte marr në pyetje një herë natën dhe dy herë gjatë ditës nga **Xh. K.** dhe nga një i ashtuquajtur i prokurori S. D..⁶⁹

118. Gjithashtu, raporti i ekzaminimit fizik të Dëshmitarit H e vërteton prezencën e lëndimeve të vjetra në trupin e Dëshmitarit, përfshirë këtu shenjat në ballë dhe në gjoks, dhe bërryli i majtë lehtë i deformuar dhe i cili ka vështirësi për tu drejtuar.⁷⁰

119. Mbi bazën e këtyre provave, gjykata vërtetoi se i pandehuri **Xh. K.**, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me S. G. dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së, kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e Dëshmitarëve A, B, C, D, E, F, H, dhe të A. B. duke i rrahur ata vazhdimisht apo duke i urdhëruar të tjerët ta bënin këtë, në K.(në veri të Shqipërisë) gjatë muajve prill, maj dhe deri në mesin e qershorit të vitit 1999. Prova për rolin e S. G. si bashkëkryerës do të diskutohet në vijim në § 121-125.

⁶⁶ Proceverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 18 prill 2016, f. 16-22 nga 51

⁶⁷ Proceverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 20-21 nga 55

⁶⁸ Proceverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 27 nga 55

⁶⁹ Proceverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 32-33 nga 55

⁷⁰ Raporti i ekzaminimit fizik të Dëshmitarit H nga doktori i Mjekësisë Ligjore të EULEX-it M. G., i datës 10 nëntor 2010, Regjistratori "K" i Prokurorisë, p. 162-184

120. Gjykata do të shtjelloj në vijim në §§ 138-150 përse e ka cilësuar përfshirjen e të pandehurit **Xh. K.** si njëri nga bashkëkryerësit.

PIKA 2, 3, 4 DHE 5

S. G. dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së

121. Pikat 2, 3, 4 dhe 5 nën Akuzën 1 cekin se i pandehuri **Xh. K.** ka kryer veprat në bashkëkryerje me ‘S. G. dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së’. Pjesëmarrja e pjesëtarëve të tjerë të UÇK-së në këto veprime rrjedh qartazi nga faktet e vërtetuara më lartë, por në gjykimin aktual emri i S. G. ishte përmendur vetëm nga Dëshmitari H dhe Dëshmitari I. I.. Dëshmitari I. I. ka dëshmuar se ai është arrestuar nga S. G.⁷¹, ndërsa Dëshmitari H e përshkruajti S. G. si bashkëkryerës në torturën e kryer në qendrën e UÇK-së në K..⁷²

122. Në gjykimin kundër G., përmes aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Apelit, është vërtetuar se S. G., së bashku me pjesëtarët e tjerë të UÇK-së, duke mbajtur pozitë komanduese në kampin e K., ka kryer disa nga faktet të cilat janë vërtetuar për sa i përket të pandehurit **Xh. K.**, domethënë trajtimin çnjerëzor (Pika 1 në gjykimin kundër G.), torturë (Pika 2 në gjykimin kundër G.) dhe shkelje e integritetit trupor (Pika 3 në gjykimin kundër G.).⁷³

123. Faktet e vërtetuara në aktgjykimin e plotfuqishëm munden, si *res iudicata*, të shërbejnë vetëm si prova në procedurën në mes të palëve të njëjta. Prandaj, vlera provuese e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në gjykimin kundër G., i cili ishte pranuar si provë në rastin aktual⁷⁴, është e kufizuar në faktin që S. G. është shpallur fajtor dhe dënuar për faktet e përmendura më lartë. Ky fakt megjithatë, është i mjaftueshëm për të vërtetuar bashkëkryerjen e S. G. në aktet që janë vërtetuar si të dëshmuara më lartë në Pikën 3, 4 dhe 5.

124. Për sa i përket Pikës 2, ndalim i jashtëligjshëm, e cila nuk është përfshirë në aktakuzën e S. G., provat e bashkëkryerjes të S. G. burojnë nga fakti se ai është gjetur fajtor për faktin se

⁷¹ Proceverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 20 prill 2016, f. 7 nga 27

⁷² Proceverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 47 nga 55

⁷³ Gjykata e Apelit e Kosovës, *S. G. et alii* (PAKR 966/2012), 11 shtator 2013, f. 3 nga 27

⁷⁴ Proceverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 2 gusht 2016, f. 3 nga 12

'ka pasur pozitë komanduese' në kampin e K., e vërtetuar nga dëshmia e Dëshmitarit H, i cili ka dëshmuar mbi rolin aktiv të S. G. në qendrën e UÇK-së në K..

125. Prandaj, trupi gjykues ka vërtetuar se i pandehuri **Xh. K.** ka kryer aktet nën Pikat 2, 3, 4 dhe 5 në bashkëkryerje me S. G. dhe pjesëtarët e tjerë të UÇK-së.

PIKA 6, ndalim i paligjshëm

126. Dëshmitari K, Dëshmitari I. I. (ish-dëshmitari L), Dëshmitari M dhe Dëshmitari N dëshmuar për mbajtjen e tyre të paligjshme në kampin e UÇK-së në C. dhe në një garazhe afër Pr.. Të gjithë nga ta, përveç dëshmitarit N, kanë përmendur **Xh.K.** si njërin nga kryesit.

Dëshmitari K theksoi se tre ditë më vonë, dikush kishte ardhur dhe e kishte dërguar atë në C., K.. Ata kishin shkuar me një veturë. Dëshmitari M, të cilin ai e kishte parë për herë të parë, ishte po ashtu aty. Në C. kishte disa barraka të ushtrisë, por ata kishin qëndruar në një dhomë të ndarë. Në dhomën në të cilën i dërguan, ata e gjetën I. I.. Duart e të gjithëve ishin të lidhura, derisa nuk ua zgjidhën të gjithëve. Në fillim ishte ai, Dëshmitari M, Dëshmitari I. I., Dëshmitari N dhe një person nga Maqedonia. Dera e dhomës ishte e mbyllur me çelës nga jashtë.⁷⁵ **Xh. K.** një herë kishte ardhur në dhomën në të cilën gjendeshin të gjithë ata dhe kishte pyetur se si ishte Dëshmitari K. Ai kishte ardhur dy apo tre herë.⁷⁶ Dëshmitari K kishte qëndruar rreth dy muaj në C..⁷⁷

127. Dëshmitari I. I. e kishte njohur **Xh. K.** në sallën e gjykimit.⁷⁸

Dëshmitari I. I. theksoi se ai kishte shkuar në Shqipëri më 12 prill 1999 dhe ishte arrestuar nga S. G.. Pastaj ai ishte dërguar në C. në K., ku ishin barrakat e ushtrisë të kohës së Enver Hoxhës. Ai ishte mbajtur në C. nga 12 prilli deri më 20 qershor. Kishte raste kur, në dhomën e tij, ishin mbajtur deri në 17 persona, përfshirë Dëshmitarët M, N dhe K. Dera e dhomës ishte mbyllur me çelës nga jashtë. Te dera kishte një roje. I. I. e kishte parë **Xh. K.** dy herë në C.. Herën e parë që ai e kishte parë atë, **Xh.** ishte shoferi i veturës që e kishte dërguar atë, Dëshmitarin M dhe Dëshmitarin K për në K.. Ata ishin lidhur për duarsh. Ata ishin lënë në veturë për një orë dhe pastaj i kishin kthyer përsëri në C.. Hera tjetër që I. I. e kishte parë **Xh. K.** ishte kur ata ishin granatuar nga serbët. Më 20 ose 21 qershor 1999, rreth 25 ushtarë të UÇK-së e kishin dërguar atë dhe Dëshmitarin N nga C. në Pr.. Ushtarët e UÇK-së ishin të gjithë në uniformë dhe kishin armë automatike. Ata i dërguan të dy Dëshmitarët te konviktet e femrave të shkollës teknike në Pr., ku i mbyllën në

⁷⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 14-17 nga 41

⁷⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 18 nga 41

⁷⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 19 nga 41

⁷⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 20 prill 2016, f. 11 nga 27

bodrum për dy netë dhe dy ditë. Pastaj ishte futur ushtria gjermane, duke ua marrë armët ushtarëve të UÇK-së dhe duke ua zhveshur uniformat. Dikush erdhi dhe u tha atyre se ishin të lirë dhe se ai vetëm do t'ua sillte atyre dokumentet e tyre. Pastaj ata i dërguan te një veturë. **Xh. K.** ishte vozitësi. Ata i dërguan deri në skajin e pyllit, i nxorën nga vetura dhe i shtynë përpara. Ushtarët e UÇK-së, përfshirë **Xh. K.**, ishin prapa tyre dhe njëri nga ta kishte një armë. I. I. besoi se ata do t'i qëllonin, pasi që ata thoshin se do ta bënë atë. Në fund ata mbërritën te një garazhë, ku ata ishin mbyllur brenda. Aty ata qëndruan për tre ditë, derisa dy persona erdhën dhe i thanë se ata ishin të lirë. “Shkoni në shtëpi dhe nëse i tregoni ndonjërit se keni qenë në burg ne do t'ju vrasim”, kishin thënë ata.⁷⁹

128. Dëshmitari M e përshkruajti lokacionin në C. si një ndërtesë të vjetër dy-katëshe në të cilën kishte ushtarë të UÇK-së. Ai e kishte zbuluar më vonë në C. emrin e **Xh. K.** përmes Dëshmitarit K dhe përmes bashkudhëtarit të tij A. Ha..⁸⁰

Dëshmitari M dëshmoi se ai ishte larguar nga Kosova më 27 mars 1999 për të udhëtuar për në Sh. afër D. në Shqipëri. Ai ishte arrestuar në D. më 16 prill. Ai ishte te nipi i tij, kur kishte ardhur një person i cili e identifikoi veten se punonte për shërbimin e sigurimit në Shqipëri. Jashtë ishin dy nga shokët e tij duke pritur në një xhip. Ata e hipën atë dhe nipin e tij në xhip dhe nisën të vozitnin. Ata vozitën deri te Hotel D.. Njëri nga ta i tha atij se ata nuk ishin nga shërbimi i sigurimit shqiptar por nga UÇK-ja. Këta tre persona ishin **Xh. K.**, T. T. dhe B. Ll.. Më vonë, ata e prangosën atë dhe e futën në një xhip. Pastaj ata vozitën tërë natën dhe në mëngjes ata arritën në K.. Ata e lanë atë në veturë afër barakave. Pastaj sollën një person tjetër: Dëshmitarin K, i cili gjithashtu ishte i prangosur dhe i dërguan ata në C., te një ndërtesë e vjetër dy-katëshe e cila kishte ushtarë të UÇK-së. Ata e dërguan Dëshmitarin K dhe atë në një dhomë të vogël. Dëshmitari I. I. ishte gjithashtu aty. Ata ishin të prangosur, përpara, gjatë natës së parë. Pastaj ata e dërguan atë, së bashku me Dëshmitarin K, në një zyrë në katin poshtë. Pasi që i kishin marrë në pyetje, ata i kthyen përsëri në dhomë. Dera mbahej e mbyllur nga jashtë. Ata nuk mund të largoheshin pa e hapur rojtari derën për ta. Në ditën e pestë, ai pa **Xh. K.** Atë ditë, A. H. kishte ardhur në dhomë. Ai kishte nxjerr që të tre nga dhoma, i kishte dërguar poshtë dhe i kishte futur në një xhip. Të tre nga ta ishin lidhur të gjithë së bashku në duart e tyre, njëri në dorën e tij të djathtë dhe tjetri në të majtën. **Xh. K.** ishte në ulësen e vozitësit. Ai voziti xhipin në një drejtim të panjohur. Rugës ata takuan një xhip tjetër, ngjyrë të kuqe. Vozitësi i foli **Xh. K.** dhe A. H., pastaj e ktheu veturën dhe priu i pari deri kur ata mbërritën në Kr.. H. (D.) i foli atyre, ata i morën nga vetura, ai ua hoqi prangat dhe i hipi ata në veturën e kuqe, dhe ata u kthyen përsëri në C.. Ata ishin vendosur në dhomën e njëjtë në C.. Të nesërmen H. D. erdhi në dhomë me një person tjetër dhe e dërgoi atë në Kr.. Pastaj, ai ishte

⁷⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 20 prill 2016, f. 6-19 nga 27

⁸⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 maj 2016, f. 5

dërguar në K. te shërbimi i sigurimit shqiptar, i cili e kishte mbajtur atë në një zyrë për tre ditë. Pastaj ai ishte liruar. Dëshmitari M qëndroi në C. për gjashtë ditë.⁸¹

129. Dëshmitari N nuk ishte dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, por me marrëveshjen e të dy palëve, deklaratat e tij të mëhershme ishin konsideruar si të lexuara⁸².

Dëshmitari N ka theksuar se gjatë luftës, rreth muajit mars 1999, ai ishte larguar nga rajoni i I. për të shkuar së pari në R. në Mal të Zi. Atje ai qëndroi rreth 10 deri në 15 ditë. Pastaj, ai kishte shkuar në Sh., ku kishte qëndruar në kampin e refugjatëve. Më 1 maj 1999, ai ishte ndaluar. Ai ishte dërguar në një stacion të policisë në Shqipëri, ku ishte ndaluar për 24 orë para se të lirohej. Gjatë natës së njëjtë, 12 persona erdhën dhe e ndaluan atë. Tre nga ta ishin të UÇK-së. Njëri nga ta kishte një armë. Të tjerët ishin policë të Shqipërisë. Policia e dërguan atë në një kontejner dhe nga aty, në ora 7:00 të mëngjesit, ia dorëzuan UÇK-së, e cila e transferoi atë në K. me një Mercedes taxi. Ai ishte prangosur.⁸³ Disa orë më vonë, dy pjesëtarë të UÇK-së e dërguan atë nga K. për në Kr.⁸⁴ Atje ai qëndroi rreth 2 ose 3 orë. Pastaj, ata e dërguan atë me një veturë të policisë ushtarake në C..⁸⁵ Ata e dërguan në katin e dytë, ku Dëshmitari K, Dëshmitari I. I. dhe një person nga Maqedonia ishin ndaluar. Një polic qëndronte jashtë derës. Pas tre ditësh, S. G. arriti në dy paterica. Ai tha atyre: “Ju do të kalbeni në burg”. Dëshmitari N ishte në burg për një muaj e gjysmë, përfshirë kohën e kaluar Pr.. Në C., ai qëndroi afërsisht një muaj në dhomën në katin e dytë. Dera mbahej e mbyllur me çelës, me një roje të ushtrisë te dera.⁸⁶ Aty kishte më shumë të burgosur. Dy apo tre policë gjithashtu ishin arrestuar dhe mbaheshin në një dhomë poshtë. Në dhomën në të cilën ai qëndronte, ndonjëherë ushtarët të cilët ishin nën masa disiplinore sillleshin aty për një natë apo dy. Dëshmitari M ishte larguar ditën para se të mbërrite ai. Në fakt, ai dëgjoi se Dëshmitari M kishte qenë aty, por ai asnjëherë nuk e pa atë.⁸⁷ Diku në mes datave 20 dhe 22 maj 1999, ata e morë atë nga C. dhe e dërguan në K., bashkë me I. I. dhe personin nga Maqedonia, për t’i gjykuar. Ata ishin prangosur. Ata e akuzuan atë për posedim të armëve dhe për pranimin e regjimit serb. Atij asnjëherë nuk iu dha vendimi. Pas gjykimit, ata e dërguan atë dhe I. I. përsëri në C., ndërsa personi nga Maqedonia qëndroi atje. Ata ishin prangosur bashkë. Kur arritën, Dëshmitari K ishte shumë i lumtur që i shihte sepse ai kishte dëgjuar se ata ishin vrarë.⁸⁸ Ata qëndruan edhe dhjetë ditë në C., pa u rrahur. Nga C., ata i sollën në një konvikt të studentëve në Pr.. Atyre i ishin vene dhe hequr prangat disa here. Ditën tjetër ata i dërguan në një garazh, ku ata ishin mbyllur brenda për tre

⁸¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 maj 2016, f. 4-14

⁸² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 2 nga 41

⁸³ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 10/16 mars 2010, Regjistratori i Prokurorisë D, f. D333-D342 (357-366)

⁸⁴ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 10/16 mars 2010, Regjistratori i Prokurorisë D, f. D345 (369)

⁸⁵ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 10/16 mars 2010, Regjistratori i Prokurorisë D, f. D348 (372)

⁸⁶ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 10/16 mars 2010, Regjistratori i Prokurorisë D, f. D351-354 (375-378)

⁸⁷ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 10/16 mars 2010, Regjistratori i Prokurorisë D, f. D355-356 (379-380)

⁸⁸ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 10/16 mars 2010, Regjistratori i Prokurorisë D, f. D365-356 (389-380)

ditë. Aty ishin ai, I. I., tre serbë dhe dy romë. Pas tre ditësh, ata ishin liruar nga persona të veshur në uniforma të zeza dhe atyre u ishte thënë të mos i tregonin askujt se ishin marrë të burgosur, pasi që do të vriteshin dhe familjet e tyre do të merreshin peng. Ai ishte liruar së bashku me I. I.⁸⁹

130. Bazuar në atë që u tha më lartë, trupi gjykues e gjeti të vërtetuar se i pandehuri në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, kanë ndaluar në mënyrë të paligjshme Dëshmitarët K, L, M dhe N në kampin e UÇK-së në C.(në veri të Shqipërisë) gjatë muajve prill, maj dhe deri në gjysmën e muajit qershor të vitit 1999, dhe në mënyrë të paligjshme kanë mbajtur Dëshmitarët L dhe N në një garazhe në Pr. gjatë datave të pacaktuara gjatë qershorit të vitit 1999.

PIKA 7, ndalimi i paligjshëm

131. Kjo Pikë ishte refuzuar në përputhje me nenin 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së sepse prokurori i PSRK-së gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka tërhequr pikën.

AKUZA II, Pronësi, kontrollë, posedim dhe shfrytëzim i paautorizuar i armëve

132. Detajet relevante lidhur me këtë akuzë janë dhënë në raportin mbi arrestimin e të pandehurit, të datës 07 tetor 2015.⁹⁰

133. I pandehuri është deklaruar fajtor lidhur me këtë akuzë. Prandaj, nuk ishin administruar prova të tjera .

V.7 Kualifikimi ligjor i fakteve

AKUZA 1

134. Trupi gjykues ka vlerësuar nëse faktet që janë vërtetuar përbëjnë “Krime lufte kundër popullatës civile” e kryer në bashkëkryerje siç parashihet dhe është e dënueshme me nenin 142 lidhur me nenin 22 të KP-së së RSFJ-së.

135. Neni 142 i KP-së së RSFJ-së parasheh si në vijim.

⁸⁹ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit i datës 10/16 mars 2010, Regjistratori i Prokurorisë D,f. D365-371 (389-395)

⁹⁰ Regjistratori i Prokurorisë K, f. 225-239

Kushdo që në shkelje të rregullave të ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit, urdhëron që popullata civile të jetë subjekt i vrasjeve, torturës, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjes së skajshme apo shkeljes së integritetit trupor apo shëndetit; dislokimit apo zhvendosjes apo konvertimit të dhunshëm në një komb apo religjion tjetër; prostitucionit me forcë apo përdhunimit; aplikimit të masave të frikësimit dhe terrorit, marrjes së pengjeve, imponimit të dënimit kolektiv, sjelljes së jashtëligjshme në kampe përqëndrimi dhe arrestimeve dhe ndalimeve të tjera të jashtëligjshme, privimit nga të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; shërbimit me forcë në forcat e armatosura të armatës së armikut apo në shërbimin e saj të inteligjencës apo në administratë; punës së detyrueshme, vdekjes së popullsisë nga uria, konfiskimit të pronës, vjedhjes së dhunshme, shkatërrimit dhe vjedhjes së jashtëligjshme dhe tekanjoze në masë të pronës që nuk justifikohet nga nevojat ushtarake, marrjes së një kontributi apo vendimi të jashtëligjshëm dhe jo-proporcional, zhvlerësimit të valutës vendore apo lëshimit të jashtëligjshëm të valutës, ose kushdo që kryen njërin nga aktet e mësipërme, dënohet me burgim prej jo më pak se pesë vjet ose me dënim me vdekje.

136. Neni 22 i KP-së të RFSJ-së parasheh si në vijim:

Nëse disa persona së bashku kryejnë një vepër penale duke marr pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë formë tjetër, secili nga ta dënohet siç parashihet për aktin.

137. Me qëllim të kualifikimit të akteve që janë vërtetuar më lartë nën 'faktet e vërtetuara' si krime lufte në bashkëkryerje sipas nenit 142 lidhur me nenin 22 të KP-së të RFSJ-së, duhet të vërtetohet se i pandehuri **Xh. K.** (a) bashkërisht (b) ka kryer një apo më shumë akte që parashihen me nenin 142 dhe (c) duke e bërë këtë ka shkelur njërin apo më shumë rregulla të ligjit ndërkombëtar (d) në fuqi gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit. Këto elemente përkatëse do të vlerësohen në vijim.

(a) bashkërisht

138. Siç u diskutua më lartë në § 87, trupi gjykues gjeti se jurisprudenca e TNPJ-së mund të jetë e dobishme për sa i përket interpretimit të bashkëkryerjes nga neni 22 të KP-së të RFSJ-së, por nuk mund të shtrijë zbatimin e tij përtej kufijve ligjorë që parashihen me këtë nen, pasi që kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë që është paraparë me nenin 33 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenin 2 të KPRK-së. Lloji i tretë i NPK-së (ndërmarrjes së përbashkët kriminale), varianti i gjerë, i kalon kufijtë e vendosur me nenin 22 të KP-së të RFSJ-së. I njëjti, megjithatë, nuk zbatohet për herën e dytë të NPK-së, e cila – në kundërshtim me variantin e tretë – kërkon një *dolus directus* të pjesëmarrësve në qëllimin e

përbashkët⁹¹, dhe mund dhe rrjedhimisht do shërbej si direktivë në interpretimin e trupit gjykues të ‘në një formë tjetër’ që përmendet në këtë nen.

139. Sipas TNPJ-së në aktgjykimin e vet në rastin Limaj, që të tre llojet e ndërmarrjes së përbashkët kriminale kërkojnë, për sa i përket *actus reus*, një shumësi personash, ekzistencën e një plani të përbashkët, projekti apo qëllimi, i cili përbënë apo përfshinë kryerjen e krimit, dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit në projektin e përbashkët. Për sa i përket *mens rea*, në variantin e dytë (‘sistematik), që ngërthen të ashtuquajturat lëndë mbi ‘kampin e përqendrimit’, i akuzuari ka njohuri për llojin e sistemit shtypës, në zbatimin e të cilit ai merr pjesë, dhe qëllimin për të shtrirë projektin bashkë të përgatitur për të keqtrajtuar të mbajturit në kamp. Në raste të tilla qëllimi i kërkuar mund gjithashtu të kuptohet nga njohuria e dëshmuar për krimet që kryhen në kamp dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në operimin e kampit, dhe gjithashtu nga pozita e autoritetit të mbajtur nga një i akuzuar në kamp.⁹²

Actus reus

140. Më lartë nën ‘faktet e vërtetuara’, gjykata ka vërtetuar se në K. dhe C. kishte kampe ku mbaheshin të burgosurit. Të burgosurit rriheshin rregullisht nga disa pjesëtarë të UÇK-së dhe merreshin në pyetje lidhur me bashkëpunimin e tyre të pretenduar me serbët. Në një rast, ata ishin torturuar. Gjykata ka vërtetuar gjithashtu se i pandehuri **Xh. K.** ishte i përfshirë në transportimin e tyre për në kampe dhe nga to dhe ai kishte marr pjesë në torturimin e tyre. Gjithashtu, ka prova se ai ka marr në pyetje disa nga të burgosurit.

141. *Actus reus* rrjedh nga fakti se UÇK-ja në kampet e saj në K. dhe C. ka mbajtur të burgosur me qëllimin e thjeshtë kriminal të keqtrajtimit të tyre, marrjes së informacionit mbi bashkëpunimin e tyre të pretenduar me serbë, në të cilin qëllim i pandehuri kishte marr pjesë.

Mens rea

Të qenit në dijeni për krimet që kryheshin në kamp

Pikat 2, 4 dhe 6

⁹¹ Lachezar Yanev, *Teoritë e Bashkëkryerjes në Ligjin Ndërkombëtar Penal*, 2016, f. 188

⁹² Dhoma e gjykimit e TNPJ-së, *Limaj et alii* (IT-03-66-T), Aktgjykimi, 30 nëntor 2005, Par. 511, me referenca të tjera

142. Siç u pa më lartë, juridikisht është vërtetuar se i pandehuri **Xh. K.** jo vetëm që kishte njohuri por gjithashtu drejtpërdrejtë kishte marr pjesë në kryerjen e akteve të mbajtjes të jashtëligjshme në kampet në K. dhe C. si dhe në garazhe në periferi të Pr. (Pikat 2 dhe 6), dhe se ai drejtpërdrejtë kishte marr pjesë në kryerjen e akteve të torturës (Pika 4).

Pika 3, kushte çnjerëzore

143. Bazuar në dëshminë e Dëshmitarit F, mund të vërtetohet se i pandehuri **Xh. K.** kishte njohuri për kushtet çnjerëzore në të cilat mbaheshin të ndaluarit. Dëshmitari F dëshmoi se ata kishin batanije të cilat ua kishin marrë, dhe më vonë **Xh. K.** kishte ardhur te dera, ata kishin një bisedë për batanijet dhe pastaj batanijet dhe dyshekët u ishin kthyer përsëri.

Pika 5, shkelje e integritetit trupor ose shëndetit

144. Se i pandehuri ishte në dijeni për rrahjet duket jo vetëm nga pjesëmarrja e tij në tortura siç është vërtetuar nën Pikën 4, por edhe nga dëshmia e Dëshmitarit F i cili e ka vërtetuar deklaratën e tij të mëhershme se **Xh. K.** kishte ardhur te dera e dhomës ku po mbaheshin brenda në K., e shikoi atë dhe tha: “kush të ka goditur” (...).⁹³ Gjithashtu, Dëshmitari H dëshmoi se natën e torturës i Pandehuri kishte urdhëruar njërin nga dëshmitarët për ta rrahur atë (Dëshmitarin H).

Pjesëmarrje e vazhdueshme në operimin e kampit

145. Dëshmitari F rinumëroj disa rrahjet që atij dhe shokëve të tij të dhomës u ishin bërë nga duart e disa ushtarëve të UÇK-së, pas të cilave ata kishin pyetur secilin nga ta se si quheshin dhe ku kishin punuar më parë, pasi që ishin vendosur aty si bashkëpunëtorë. Gjithashtu Dëshmitari H dëshmoi se në dhomën ku ai flinte me shokët e tjerë të dhomës, ata ishin rrahur nga njerëz të panjohur para, gjatë dhe/ose pas marrjes në pyetje, dhe se ai ishte marrë në pyetje tre herë nga **Xh. K.**, së bashku me S. D.. Dëshmitari C e përshkruajti torturën, dhe se si iu bëheshin atyre pyetje gjatë keqtrajtimit.

146. Sipas këtyre dëshmive, gjatë qëndrimit të tyre në qendrën e UÇK-së në K., të ndaluarit janë rrahur pastaj janë marrë në pyetje dhe anasjelltas. Nga këndvështrimi i trupit gjykues, rrahjet nuk mund të veçohen nga konteksti në të cilin kanë ndodhur. Rrahjet qartazi kanë

⁹³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 18 prill 2016, f. 9 nga 51

kontribuar në marrjen në pyetje dhe *vice versa*, dhe kështu të dyja kanë pasur qëllimin e nxjerrjes së një deklaratë apo pranimit të fajtit nga të ndaluarit. Veçanërisht Dëshmitari H kishte treguar se pandehuri **Xh. K.** ishte personi që kryente marrjet në pyetje. Kështu, i pandehuri kishte vazhduar pjesëmarrjen e tij në operimin e kampit.

Pozita me autoritet e mbajtur nga i pandehuri

147. Më lartë në §§ 76-77, gjykata nuk e ka vërtetuar se i pandehuri mbante pozitë me gradë të lartë në Qendrën e UÇK-së në K. (Shqipëri). Megjithatë, nga dëshmitë e Dëshmitarit F dhe Dëshmitarit K, mund të kuptohet se i pandehuri kishte një ndikim të caktuar në kamp.

148. Siç shihet më lartë në § 101, Dëshmitari F ka dëshmuar se ata kishin batanije të cilat iu ishin marrë dhe më vonë **Xh. K.** kishte ardhur te dera, ata kishin pasur një bisedë për batanijet dhe disa orë më vonë dikush ua solli ato përsëri. Dëshmitari K theksoi se kur ishte në kampin në K., kur i kishte thënë **Xh. K.** se ai ishte i mërzhitur, një mësues ishte sjell në qelinë e tij. Ai gjithashtu u vizitua nga një mjek.⁹⁴ Kur një femër e burgosur ishte sjell në dhomë, Dëshmitari K kishte kërkuar nga **Xh. K.** për të intervenuar dhe ajo ishte larguar nga aty.⁹⁵

149. Gjithashtu, nga dëshmia e Dëshmitarit K, duket se i pandehuri **Xh. K.** ishte në pozitë për të ndikuar vendimin mbi lirimin e tij. Në fakt, Dëshmitari K dëshmoi se në ditën e lirimit të tij, **Xh. K.** kishte ardhur dhe i kishte thënë se përveç nëse do e vrisnin, ai (**K.**) do ta lironte atë. Pas daljes para gjyqtarit, i cili i tha atij se ai ishte plotësisht i pafajshëm (...), të njëjtën pasdite, ai ishte liruar.⁹⁶

150. Ajo që u tha më lartë është e mjaftueshme për të konstatuar se i pandehuri **Xh. K.** kishte mbajtur një pozitë me autoritet në kampin e K..

Konkludimi përkohshëm

151. Sipas kriterit në rastin Limaj të TNPJ-së në interpretimin e vet të bashkëkryerjes nën nenin 22 të KP-së së RSFJ-së, gjykata vërtetoi se i pandehuri **Xh. K.**, përveç pjesëmarrjes së

⁹⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 23 nga 41

⁹⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 25 nga 41

⁹⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 24 maj 2016, f. 30 nga 41

tij të drejtpërdrejtë dhe aktive në mbajtjen e paligjshme në qendrat e UÇK-së në K. dhe C. dhe torturimin e disa të ndaluarve në K., kishte njohuri për kushtet çnjerëzore në të cilat ata mbaheshin dhe për shkeljen e integritetit të tyre trupor ose shëndetit që kryheshin në kampin në K., dhe kishte vazhduar pjesëmarrjen e tij në operimin e kampit, derisa mbante pozitë me autoritet në të. Kriteri *actus reus* njësoj është përmbushur, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ka kryer aktet e vërtetuara nën Pikën 2 deri në Pikën 6 ‘bashkërisht, duke marrë pjesë drejtpërdrejtë në aktin e kryerjes apo në ndonjë formë tjetër, në kuadër të kuptimit të nenit 22 të KP-së së RSFJ-së.

(b) një apo më shumë akte që parashihen me nenin 142

152. Aktet e torturës (Pika 4), kushte çnjerëzore (‘trajtim çnjerëzor’ në nenin 142) (Pika 3), shkelje e integritetit trupor apo shëndetit (Pika 5) dhe arrestime dhe mbajtje të paligjshme (Pika 2 dhe 6), të gjitha këto shprehimisht parashihen nga neni 142. Të gjitha këto akte ishin drejtuar kundër civilëve, siç do të shihet në vijim në § 155.

(c) ka shkelur një apo më shumë rregulla të ligjit ndërkombëtar

153. Aktakuza i referohet nenit 3 të Përbashkët për Konventat e Gjenevës të vitit 1949 (në tekstin vijues: ‘neni 3 i Përbashkët’) dhe neneve 4 dhe 5 të Protokollit Shtesë II (në tekstin vijues: ‘PSh2’).

154. Në aktet e përshkruara më lartë, trupi gjykues i gjeti rregullat vijuese relevante:

- Nga neni 3 i Përbashkët: (1) Personat që nuk marrin pjesë aktive në veprimet ushtarake (...) në të gjitha rrethanat trajtohen në mënyrë njerëzore (...);
- Nga neni 4 i PSh2 (Garancitë thelbësore): Par. 1. Të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë (...) në veprimet ushtarake, pavarësisht nëse liria e tyre është kufizuar, kanë të drejtë në respektimin e personalitetit të tyre (...). Në të gjitha rrethanat ata trajtohen në mënyrë njerëzore (...);
- Nga neni 5 i PSh2 (Personat liria e të cilëve është kufizuar): Par. 1. Nën (b): [personave liria e të cilëve është privuar në lidhje me konfliktin e armatosur], në të njëjtën masë si dhe popullatës civile lokale, i ofrohet ushqimi dhe uji i pijshëm dhe i

ofrohet mbrojtje për sa i përket shëndetit dhe higjienës dhe mbrojtje nga klima ekstreme dhe rreziqet e konfliktit të armatosur; dhe Par. 2. Nën (e): shëndeti i tyre fizik ose mendor dhe integriteti nuk duhet të rrezikohet nga ndonjë veprim ose mosveprim i paarsyeshëm.

155. Të gjithë dëshmitarët ishin civilë, të privuar nga liria e tyre në lidhje me konfliktin e armatosur (PSh2 neni 5), dhe nuk ka ndonjë tregues se ndonjëri nga dëshmitarët apo palët e dëmtuara të kenë marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë (PSh2 neni. 4) apo në mënyrë aktive (neni 3 të Përbashkët) në veprimet ushtarake. Përkundrazi, Dëshmitarja C theksoi se ajo kishte punuar për Dëshmitarin B në kafiteri⁹⁷; Dëshmitari D dëshmoi se ai nuk ishte pjesëtar i UÇK-së dhe as ndonjë force tjetër⁹⁸; Dëshmitari E dëshmoi se ai ishte muzikant dhe një punëtor i thjeshtë⁹⁹; Dëshmitari F dëshmoi se ai ishte roje pylli para luftës¹⁰⁰; Dëshmitari H dëshmoi se ai ishte polic deri dy vite para luftës, ai ishte larguar nga shërbimi nga forcat serbe.¹⁰¹; Dëshmitari K dëshmoi se ai ishte mësues deri në vitin 1985 dhe pastaj ishte nëpunës në zyrën rajonale, dhe gjithashtu se nga maji deri në gusht 1998, ai ishte komandant i forcës së mbrojtjes civile në fshatin e tij B., dhe rrjedhimisht ai ishte përfshirë në evakuimin e popullatës civile më 7 korrik 1998, kur ata ishin sulmuar nga forcat serbe; Dëshmitari M dëshmoi se ai kishte punuar si inspektor i sigurimit të shtetit para luftës dhe ishte larguar nga puna në vitin 1990 dhe se ishte i papunë që nga atëherë¹⁰²; dhe Dëshmitari N theksoi se ai ishte anëtar aktiv i partisë socialiste të Serbisë.¹⁰³

156. Aktet e ndalimit të paligjshëm, kushteve çnjerëzore (ose: trajtimit çnjerëzor), torturës dhe shkeljes së integritetit trupor apo shëndetit, të gjitha këto rezultojnë në trajtimin çnjerëzor (neni 3 i Përbashkët dhe PSh2 neni 4) dhe në shkeljen e shëndetit apo integritetit fizik apo mendor (PSh2 neni 5) të të ndaluarve.

157. Kështu trupi gjykues gjeti shkelje të një apo më shumë rregullave të ligjit ndërkombëtar.

(d) në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit

⁹⁷ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 17 dhjetor 2009, Regjistratori i prokurorisë C2, f. C290 (180)

⁹⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 13 prill 2016, f. 7 nga 51

⁹⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 13 prill 2016, f. 34 nga 51

¹⁰⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 18 prill 2016, f. 4 nga 51

¹⁰¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 prill 2016, f. 6 nga 55

¹⁰² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 25 maj 2016, f. 4

¹⁰³ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit të datës 10/16 mars 2010, f. Regjistratori i prokurorisë D, f. D333 (357)

158. Ish-Jugosllavia, përfshirë (atëherë) krahinën e Kosovës dhe Metohisë, ishte bërë palë e lartë kontraktuese e Konventave të Gjenevës më 15 dhjetor 1950 dhe e protokolleve shtesë më 28 dhjetor 1978.

159. Neni 3 i Përbashkët parasheh si në vijim:

Në rast të konfliktit të armatosur jo të karakterit ndërkombëtar që ndodh në territorin e njërit nga Palëve të Larta Kontraktuese (...).
(...)

160. Neni 1 i Protokollit Shtesë II të vitit 1977 (në tekstin e mëtejshëm: 'PSh2') parasheh:

Baza materiale e zbatimit

Ky protokoll, i cili e zhvillon dhe e plotëson nenin 3 të përbashkët të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 pa ndryshuar kushtet e tij ekzistuese të zbatimit, zbatohet për të gjitha konfliktet e armatosura të cilat nuk parashihen me nenin 1 të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe që kanë të bëjnë me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokollit I) dhe të cilat ndodhin në territorin e Palës së Lartë Kontaktuese në mes të forcave të armatosura të saj dhe forcave të armatosura disidente apo grupeve të tjera të armatosura të organizuara të cilat, nën komandë të përgjegjshme, ushtrojnë një kontroll të tillë mbi një pjesë të territorit të vet për t'i mundësuar ata të kryejnë operacione të qëndrueshme dhe të përqendruara ushtarake dhe për të zbatuar këtë Protokoll.

(...)

161. Neni 3 i Përbashkët zbatohet për konfliktet "jo të karakterit ndërkombëtar". Siç është vlerësuar tanimë nga Gjykata e Qarkut të Mitrovicës në gjykimin kundër G.¹⁰⁴, për ta përmbushur definicionin e "konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar", duhet përmbushur pragu minimal. Ndërsa neni 3 i Përbashkët thjeshtë kërkon që konflikti i armatosur të mos jetë i "karakterit ndërkombëtar" dhe të ndodhë "në territorin e njërit prej vendeve të Palëve të Larta Kontraktuese" (që të dy këto kushte janë përmbushur në rastin në fjalë), prag më i lartë zbatohet nën PSh2. PSh2 zbatohet vetëm në konfliktet në mes të forcave të armatosura të Palës së Lartë Kontraktuese dhe "forcave të armatosura disidente apo grupeve të tjera të organizuara të armatosura të cilat, nën komandë të përgjegjshme ushtrojnë një kontroll të tillë mbi një pjesë të territorit sa për t'i mundësuar ato të kryejnë veprime ushtarake të qëndrueshme dhe të përqendruara."

¹⁰⁴ Gjykata e Qarkut e Mitrovicës, *S. G. et alii* (P 45/2010), Aktgjykimi i datës 29 korrik 2011, Par. 25 ff

162. Nuk kontestohet se UÇK-ja dhe forcat serbe ishin përfshirë në një konflikt të tillë të armatosur. Sipas aktakuzës, krimet e pretenduara ishin kryer në periudhën në mes të prillit dhe qershorit 1999. Ekzistenca e një konflikti të armatosur në mes të forcave serbe dhe UÇK-së në periudhën përkatëse ishte vërtetuar me Vendimin e Gjykatës Supreme të datës 21 korrik 2005 në rastin *Latif Gashi et alii*.¹⁰⁵ Ky vendim gjithashtu konstatoi se struktura organizative e UÇK-së kishte përmbushur kërkesat e lartë-përmendura sipas PSh2.¹⁰⁶
163. Kështu kushtet e nenit 3 të Përbashkët dhe PSh2 ishin përmbushur dhe ato dispozita ishin aktivizuar në konfliktin e armatosur jo-ndërkombëtar në mes të forcave të Qeverisë së Serbisë dhe UÇK-së në Kosovë. Por në rastet kur një shtet i huaj i ofron ndihmë ushtarake një grupi të armatosur që vepron kundër qeverisë, konflikti bëhet me karakter ndërkombëtar. Në këtë rast, bombardimi i caqeve të ushtrisë serbe nga NATO-ja kishte filluar më 24 mars 1999.
164. Trupi gjykues plotësisht pajtohet me Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës në gjykimin kundër G.¹⁰⁷ se statusi apo zbatueshmëria e nenit 3 të Përbashkët dhe PSh2 nuk kanë ndryshuar me fillimin e bombardimeve të NATO-s. Sipas Komentarit të Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar (KKKN) lidhur me nenin 3 të Përbashkët: “[vlera e dispozitës nuk kufizohet në fushën që trajtohet me nenin 3. Rrjedhimisht, siç paraqitet, minimumi i cili duhet të aplikohet në konfliktin më të vogël, kriteret e tij aq më shumë duhet të zbatohen në rastin e konflikteve ndërkombëtare kur të gjitha dispozitat e Konventës janë të zbatueshme. Siç mund të thuhet se “obligimi më i madh ndërthun në vete atë më të vogël ”,¹⁰⁸
165. Kjo duhet njësoj të zbatohet ndaj dispozitave të PSh2, jo vetëm për shkak se PSh2, sipas nenit 1 paragrafit 1 të tij, “krijon dhe plotëson nenin 3 të Përbashkët (...) pa ndryshuar kushtet e tij ekzistuese të zbatimit”, por edhe sepse nuk mund të pranohet se shkalla e mbrojtjes që i ofrohet civilëve në bazë të Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve të tyre shtesë gjatë konfliktit në mes të UÇK-së dhe forcave serbe ka ndryshuar në dëm të tyre si rezultat i bombardimit të NATO-s.

¹⁰⁵ Gjykata Supreme e UNMIK-ut, *Latif Gashi et alii* (AP-KZ 139/2004), Vendimi i datës 21 korrik 2005, f. 9-11

¹⁰⁶ Gjykata Supreme e UNMIK-ut, *Latif Gashi et alii* (AP-KZ 139/2004), Vendimi i datës 21 korrik 2005, f. 10

¹⁰⁷ Gjykata e Qarkut e Mitrovicës, *S.G. et alii* (P 45/2010), Aktgjykimi i datës 29 korrik 2011, Par. 28.

¹⁰⁸ Shih gjithashtu TNPJ, Dhoma e Apelit, *Dusko Tadic* (IT-94-1), Vendimi mbi Propozimin e Mbrojtjes për Ankesë të Përkohshme mbi Juridiksionin, 2 tetor 1995, Par. 109

Zbatimi territorial dhe kalimtar

166. Gjykata e Qarkut e Mitrovicës në gjykimin në rastin G. gjeti se fakti që ngjarjet e pretenduara kanë ndodhur tërësisht brenda territorit të Shqipërisë, e cila nuk kanë marrë pjesë në konfliktin e armatosur, nuk ndikon në zbatueshmërinë e nenit 3 të Përbashkët dhe PSh2, ndonëse të dy përmendin ‘ndodhjen (ose: ‘zhvillimin’) e konfliktit të armatosur në territorin e një shteti të lartë kontraktues’.¹⁰⁹ Ky konstatim ishte vërtetuar në ankesë.¹¹⁰
167. Gjykata e Qarkut e Mitrovicës, në aktgjykimin e vet, ka zbatuar kriterin që është vendosur në rastet Tadic¹¹¹ dhe Blaskic¹¹², për të konstatuar se kampet (apo qendrat) në K. dhe C. ishin nën kontrollin e njëres nga palët e konfliktit, pra UÇK-së, dhe prandaj duhet të konsiderohen si ‘territor’ në kuadër të kuptimit të nenit 3 të Përbashkët dhe PSh2. Gjithashtu ajo gjeti një *nexus* të qartë në mes të UÇK-së, viktimave të pretenduara të mbajtjes dhe konfliktit të armatosur në Kosovë. Prandaj, ajo konstatoi se krimet e pretenduara bien në kuadër të nenit 3 të Përbashkët dhe PSh2.¹¹³ Trupi gjykues pajtohet plotësisht me këto gjetje, të cilat zbatohen njësoj në rastin aktual.
168. Nën Pikën 6 përfshihet mbajtja e paligjshme e Dëshmitarëve L (I. I.) dhe N në një garazhë në Pr. në datat e papërcaktuara gjatë qershorit 1999. Nga dëshmitë e Dëshmitarit, duket se kjo mbajtje kishte ndodhur disa ditë pas datave 20 ose 21 qershor të vitit 1999.
169. Gjykata thekson se, sipas rastit Tadic, ligji humanitar ndërkombëtar zbatohet që nga fillimi i (...) konflikteve të armatosura dhe vazhdon përtej ndalimit të veprimeve ushtarake deri në arritjen përfundimtare të paqes.¹¹⁴ Dhe ndonëse më 20 qershor 1999 tërheqja serbe kishte përfunduar dhe KFOR-i ishte vendosur mirë në Kosovë¹¹⁵, në rastin aktual duhet të merret parasysh data 20 shtator 1999 dhe jo më herët se ajo datë, pasi që atëherë ishte arritur

¹⁰⁹ Gjykata e Qarkut e Mitrovicës, *S. G. et alii* (P 45/2010), Aktgjykimi i datës 29 korrik 2011, Par. 37-42

¹¹⁰ Gjykata e Apelit, *S. G. et alii* (PAKR 966/2012), Aktgjykimi i datës 11 shtator 2013, Par. 64

¹¹¹ TNPJ, Dhoma e Apelit, *Dusko Tadic* (IT-94-1), Vendimi mbi Propozimin e Mbrojtjes për Ankesë të Përkohshme mbi Juridiksionin, 2 tetor 1995, Par. 67

¹¹² TNPJ, Dhoma e Apelit, *Blaskic* (IT-95-14), Aktgjykimi datës 3 mars 2000, Par. 69-72

¹¹³ Gjykata e Qarkut e Mitrovicës, *S. G. et alii* (P 45/2010), Aktgjykimi i datës 29 korrik 2011, Par. 46

¹¹⁴ TNPJ, Dhoma e Apelit, *Dusko Tadic* (IT-94-1), Vendimi mbi Propozimin e Mbrojtjes për Ankesë të Përkohshme mbi Juridiksionin, 2 tetor 1995, Par. 70

¹¹⁵ <http://www.nato.int/kosovo/history.htm>

marrëveshja për të demilitarizuar UÇK-në dhe për ta shndërruar atë në Trupat Mbrojtëse të Kosovës¹¹⁶.

170. Nga ajo që u tha më lartë rrjedh se neni 3 i Përbashkët dhe nenet 4 dhe 5 të PSh2 të tyre, ishin në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur dhe gjatë gjithë kohës dhe vendeve relevante në rastin aktual.

Konstatim

171. Trupi gjykues e ka vërtetuar se i pandehuri **Xh. K.** së bashku ka kryer njërin apo më shumë veprime të parapara me nenin 142, dhe duke e bërë këtë ka shkelur një apo më shumë rregulla të ligjit ndërkombëtar në fuqi gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit. Prandaj, veprimet e tij, siç janë vërtetuar nën ‘faktet e vërtetuara’, cilësohen si krime lufte dhe janë të dënueshme sipas nenit 142 lidhur me nenin 22 të KP-së së RSFJ-së.

AKUZA II

172. I pandehuri është deklaruar fajtor për këtë akuzë. Të gjeturat e NjHKL-së janë paraqitur në raportin e tyre mbi arrestimin e të pandehurit, të datës 7 tetor 2015, i cili përfshinë konfiskimin e objekteve në fjalë¹¹⁷. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve kualifikohet sipas nenit 374 të KPRK-së, por, ndryshe nga ajo që theksohet në dispozitiv, përdorimi i armëve nuk mund të dëshmohet.

VI LLOGARITJA E DËNIMIT

AKUZA I

Lex mitior

173. Në përputhje me nenin 3 paragrafi 2 të KPRK-së, në rast të ndryshimit të ligjit të aplikueshëm për një rast të caktuar para vendimit të plotfuqishëm, aplikohet ligji më i favorshëm për kryerësin.

¹¹⁶ Heinke Krieger, *Konflikti i Kosovës dhe Ligji Ndërkombëtar: Dokumentacion Analitik 1974-1999* Cambridge University Press, 2001, f. 532

¹¹⁷ Regjistrori i prokurorisë K, p. 225-239

174. Neni 22 i KP-së së RSFJ-së parasheh si në vijim:

Nëse disa persona së bashku kryejnë veprë penale duke marr pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë formë tjetër, secili nga ta dënohet siç parashihet për veprën.

175. Dispozita përsëritet në kuadër të KPRK-së aktual në nenin 31, ku theksohet se:

Kur dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprë penale duke marr pjesë në kryerjen e veprës penale apo duke kontribuar në mënyrë domethënëse në kryerjen e saj në ndonjë formë tjetër, secili nga ta mbahet përgjegjës dhe dënohet siç parashihet për veprën penale.

176. Neni 142 i KP-së së RSFJ-së parasheh:

Kushdo që në shkelje të rregullave të ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit, urdhëron që popullata civile t'i nënshtrohet vrasjeve, torturës, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjes së skajshme apo shkeljes së integritetit trupor apo shëndetit; dislokimit apo zhvendosjes apo konvertimit të dhunshëm në një komb apo religjion tjetër; prostitucionit me forcë apo përdhunimit; aplikimit të masave të frikësimit dhe terrorit, marrjes së pengjeve, imponimit të dënimit kolektiv, sjelljes së jashtëligjshme në kampe përqëndrimi dhe arrestimeve dhe ndalimeve të tjera të paligjshme, privimit nga të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; shërbimit me forcë në forcat e armatosura të armatës së armikut apo në shërbimin e saj të inteligjencës apo në administratë; punës së detyrueshme, vdekjes së popullsisë nga uria, konfiskimit të pronës, vjedhjes së dhunshme, shkatërrimit dhe vjedhjes së jashtëligjshme dhe tekanjoze në masë të pronës që nuk justifikohet nga nevojat ushtarake, marrjes së një kontributi apo vendimi të jashtëligjshëm dhe jo-proporcional, zhvlerësimit të valutës vendore apo emetimit të jashtëligjshëm të valutës, ose kushdo që kryen njërin nga aktet e mësipërme, dënohet me burgim prej jo më pak se pesë vjet ose me dënim me vdekje.

177. Neni fillestar 142 i KP-së së RSFJ-së ishte ndryshuar me amendamentet e datës 16 korrik 1993 dhe dënimi me vdekje i paraparë me këtë nen ishte zëvendësuar me 'burgim prej 20 vitesh'.

178. KKPK-ja e tanishme në nenin 152 në paragrafin e saj të parë deklaron:

Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dënohet me burgim së paku pesë (5) vjet ose me burgim të përjetshëm.

179. Gjersa neni 41 i KPRSFJ-së ofron 'parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit', duke përmendur në mënyrë të veçantë shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është

kryer vepra, shkallën e rrezikut apo dëmtimit të objektit të mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, gjendjen e tij personale dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera që lidhen me personalitetin e kryerësit, KPRK-ja në nenin 74 përmban udhëzime më të hollësishme mbi zbutjen dhe ashpërsimin e dënimeve. Ligjvënësi megjithatë ka shtuar se gjyqtari nuk është i kufizuar nga rrethanat e renditura në këtë nen.

180. Pasi që të dy nenet, neni 152 paragrafi 1 i lexuar së bashku me nenin 31 të KPRK-së dhe neni 142 i lexuar së bashku me nenin 22 të KPRSFJ-së, parashikojnë një dënim minimal prej pesë vjetëve burgim dhe nuk mund të përcaktohet cili Kod është më i favorshëm për të pandehurin kur është fjala për rrethanat rënduese dhe lehtësuese, KP i RSFJ-së vlen.

181. Në caktimin e dënimit, Gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat përkatëse të rastit.

182. Në veçanti, Gjykata konsideroi si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri nuk e ka shprehur në ndonjë fazë të procedurës se është përgjegjës për keqtrajtimin e të burgosurve në kampet e K. dhe C. e as nuk ka shfaqur ndonjë shenjë të pendimit. Faktet, të cilat në mënyrë të qartë cilësohen si një abuzim i tepruar i forcës, padyshim kanë shkaktuar si dëme fizike ashtu dhe psikologjike tek viktimat.

183. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata mori parasysh faktin se i pandehuri ka treguar pak humanitet ndaj të burgosurve duke ua kthyer atyre batanijet e tyre. Megjithatë, kjo ishte, larg nga të qenurit e mjaftueshme për të lehtësuar vuajtjet e tyre. Arsyet e mësipërme e detyruan Gjykatën që të shqiptojë dënimet siç përmenden në dispozitiv. Dënimi unik prej tetë viteve burgim korrespondon me seriozitetin e krimeve në kontekstin në të cilin ato janë kryer.

PIKA II

184. Gjoha e shqiptuar ndaj të pandehurit për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve është në përputhje me seriozitetin e veprave penale nga njëra anë dhe të ardhurat e kufizuara të të pandehurit, pasuritë e tij dhe obligimet e tij personale në anën tjetër.

VII SHPENZIMET E PROCEDURËS

185. I pandehuri **Xh. K.**, në vend se të bashkëpunojë me drejtësinë dhe të paraqitet si një i pandehur në gjykimin kundër S. G. dhe bashkë-kryerësve të tjerë, zgjodhi që të qëndrojë në arrati. Ky gjykim do të mund të ishte shmangur nëse i pandehuri do të kishte qenë në dispozicion në vitin 2011. Prandaj, Gjykata e mban të pandehurin përgjegjës për shpenzimet që lidhen me gjykimin për shumën e caktuar që përmendet në dispozitiv. Gjykata nuk gjen asnjë arsye për ta larguar tërësisht ose pjesërisht të pandehurin nga detyrimi i kompensimit të këtyre shpenzimeve e gjykata nuk e merr parasysh as faktin se i pandehuri është liruar për akuzën 1 pika 1, pasi që këto shpenzime nuk mund të caktohen veçmas nga shpenzimet e përgjithshme .

VIII SENDET E KONFISKUARA

186. Gjatë bastisjes dhe arrestimit të të pandehurit **Xh. K.**, oficerët e NJHKL-së kanë gjetur dhe konfiskuar, në mesin e sendeve të tjera, një pistoletë M57, kal.7.62 nr.ser. 19Z45Z, 2 karikatorë të mbushur- gjithsej 19 plumba, 1 thikë të mprehtë të zezë që mbyllet, 1 thikë të mprehtë të gjelbër që mbyllet, 1 thikë të kuqe me shumë funksione dhe 1 këllëf të pistoletës¹¹⁸ . Këto sende janë konfiskuar përkohësisht me vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 12 tetor 2015 dhe ato do të shkatërrohen në pajtim me nenin 115 paragrafi 5 i KPP-së.

IX KËRKESA PASURORE JURIDIKE

187. Asnjë kërkesë pasurore juridike nuk ishte paraqitur në këto procedura. Të dëmtuarit janë udhëzuar që të ushtrojnë kërkesat e tyre pasurore juridike në kontest civil.

Kryetare e trupit gjykues

¹¹⁸ Raport njoftues për arrestim, Regjistratori i prokurorisë K, f. 228

Katrien Gabriël Witteman

Këshillë juridike: Në bazë të nenit 380 të KPP-së, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Mitrovicës.